

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5656
E martë, 18 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Fillon aplikimi për legalizimin e armëve ilegale I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

VENDIMET E GUXIMSHME I SJELLIN NDRYSHIMET E MËDHA F. 12



Nga Jakup KRASNIQI

BAHTIRI PARALAJMËRON PETICION TË QYTETARËVE PËR BASHKIMIN E MITROVICËS F. 6

FILLON STABILIZIMI I PALLATIT TË RINISË, PAGUHEN PAGAT E PUNËTORËVE F. 7



EKONOMI

NË KOSOVË JANË 43 KËMBIMORE F. 9

OEAK-u: PROKURIMI PUBLIK, ZHVILLIME TË REJA PËR TRANSPARENCË MË TË MADHE F. 9

SPORT

ARRIHET MARRËVESHJA PËR MENAXHIMIN E STADIUMIT 'FADIL VOKRRI' F. 18

LIVERPOOL - BAYERN, FINALJA E PARAKOHSHME NË LIGËN E KAMPIONËVE F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI I FAQE 4-5

Delegacioni shtetëror për dialog s'ka legjitimitet të mjaftueshëm

Ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, ka bërë me dije se për fazën finale të dialogut me Serbinë, Kosovës i duhet një delegacion gjithëpërfshirës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se delegacioni i votuar në Kuvendin e Kosovës nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm për ta përfaqësuar Kosovën në këtë proces. Sipas Tahirit, legjitimiteti i nevojshëm do të arrihej vetëm me përfshirjen në delegacion edhe të dy partive më të mëdha opozitare, LDK-së dhe LV-së. Ndonëse ka mirëpritur miratimin e rezolutës për dialogun, ajo nuk pajtohet me bashkëkryesimin e delegacionit nga Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj



ËSHTË MBAJTUR TAKIMI I TRETË PËR STABILIZIM ASOCIIM NDËRMJET KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN NË BRUKSEL I FAQE 3

BE-ja nuk arrin ta bindë Kosovën për heqjen e taksës ndaj Serbisë



Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian as të hënën nuk kanë arritur ta bindin Kosovën për ta hequr taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Madje takimi për MSA-në ndërmjet Kosovës dhe BE-së, i kryesuar nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, është përshkruar me tensione. Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka thënë se dialogu për normalizim në mes të Kosovës dhe Serbisë ka dalë nga binarët me diskutimin e idesë për korrigjim të kufirit dhe shkëmbimit të territorit

Kurti kritikon propozimin e Qeverisë për marrëveshjen gjithëpërfshirëse me Serbinë I FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vazhdon protesta e studentëve, ende pa dialog dhe zgjidhje

Studentët kanë ndërprerë mësimin prej dy javësh dhe thonë se kërkesat e tyre janë të panegociueshme dhe se nuk do të bisedojnë me asnjë prej autoriteteve shtetërore dhe universitare. Të hënën qindra studentë kanë bllokuar akset kryesore në Tiranë duke shkaktuar kaos në trafik

TIRANË, 17 DHJETOR - Qindra studentë nga e gjithë Shqipëria janë shpërndarë nëpër rrugët e kryeqytetit të vendit, duke bllokuar akset kryesore të tij dhe duke shkaktuar kaos në trafik. Ky aksion vjen pas 13 ditësh të protestave të vazhdueshme të studentëve të universiteteve publike të Shqipërisë, të cilët i kanë 8 kërkesa drejtuar Qeverisë së vendit. Në këto kërkesa përfshihen: përgjysmim i tarifave të shkollimit, të rritet buxheti i arsimit dhe kërkesa të tjera për të marrë pjesë në bordet e menaxhimit të fakulteteve dhe në zgjedhjen e drejtuesve të universiteteve. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili i ka ftuar vazhdimisht studentët për dialog, edhe të hënën përmes rrjeteve sociale e ka bërë të njëjtën gjë. Megjithatë, ai në "Twitter" u ka thënë studentëve se partitë opozitare janë infiltruar në protestën e tyre jopolitike. "A mund t'ju pyes juve që ju mësojnë doktoresha (referencë për Monika Kryemadhin nga

LSI) dhe artisti (referencë për Lulzim Bashën nga PD) t'i bllokoni rrugët e qytetit e dyert e fakulteteve, ndërkohë që mbani bllokuar rrugën e dialogut, duke iu hedhur në fytyrë me sharje e akuza atyre që duan dialog: Po çfarë borxhi ju kanë juve qytetarët e studentët e tjerë?", ka shkruar kryeministri Rama. Protestuesit kanë ndërprerë mësimin prej dy javësh dhe thonë se kërkesat e tyre janë të panegociueshme dhe se nuk do të bisedojnë me asnjë prej autoriteteve shtetërore dhe universitare. "Kemi hasur vetëm në tallje nga ana e kryeministrit, me postime në rrjete sociale", tha një protestues në mesin e studentëve të rrethrotullimi i "Zogut të Zi". "E kemi thënë para dy javësh, dhe po e themi përsëri, se nuk kemi për çfarë të dialogojmë. Kërkesat tona janë të qarta, plotësoni ato, përndryshe do të përballemi me protesta pa afat", tha një tjetër protestues. Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, ka



thënë se i përkrah studentët me "shpirt dhe me mendje". Ai shtoi se nuk ka nevojë që PD-ja të bëjë akte protagonizmi. "Prindërit janë atje për t'i mbështetur dhe jam i vetëdijshëm që nuk ka nevojë, përkundrazi kundërshtari politik po mundohet ta instrumentalizojë politikisht këtë çështje, që nuk ka nevojë të bëjmë akte protagonizmi për t'i shërbyer pikërisht propagandës së ndyrë që Edi Ramës, i cili prej 13 ditësh po i torturon këta të rinj", tha Basha. Shqipëria është një nga vendet më të varfra në Evropë me GDP prej 4,868 dollarë për kokë banori,

ndërkohë që sipas Bankës Botërore në vitin 2017, është shpenzuar në arsim 2.49% të GDP, që është nën mesataren evropiane. Studentët protestues kërkojnë rritjen e buxhetit për arsim në 5% të GDP-së dhe kanë këmbëngulur se do të vazhdojnë protestat deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, javën e kaluar ka vendosur të kthejë për rishqyrtim në Kuvend Ligjin për buxhetin e vitit 2019, me qëllim rishqyrtimin e tij pas kërkesave të studentëve. Kuvendi i Shqipërisë të enjten e

kësaj jave do të mblidhet për të biseduar për këtë çështje. Tarifat vjetore për studentët në universitetet shtetërore të Shqipërisë, variojnë nga 25 mijë lekë (rreth 200 euro) deri në 40 mijë lekë (rreth 325 euro) në ciklin e parë të studimeve (bachelor). Ndërsa për ciklin e dytë të studimeve, sipas profilit që ndjekin, tarifat variojnë nga 63 mijë (rreth 510 euro) deri në 204 mijë lekë (rreth 1,600 euro). Tarifat e shkollimit në universitetin shtetëror të Shqipërisë konsiderohen të jenë ndër më të lartat në rajon dhe Evropë, sa i përket shkollimit publik.

Engeli: BE-ja menjëherë t'ia japë Kosovës liberalizimin



WASHINGTON, 17 DHJETOR - Kongresisti amerikan Eliot Engel ka vlerësuar se shumë gjëra të mira kanë ndodhur këtë javë në Kosovë, duke përmendur edhe formimin e Ushtrisë së Kosovës. Engel e drejtoi gishtin nga Serbia duke thënë se është i zemëruar me të, pasi që ajo nuk po i përmbush premtimet që i ka bërë dhe po tenton ta bllokojë Kosovën. "Gjithmonë ua dedikoj dashurinë dhe energjinë njerëzve të Kosovës dhe të Shqipërisë. Shumë gjëra të mira kanë ndodhur këtë javë, me theks të veçantë në Kosovë. Pas disa vitesh, ata arritën ta krijojnë ushtrinë e tyre

në Kosovë, mendoj se është një hap i rëndësishëm dhe shumë i mirë për të vazhduar përpara. Mendoj që secili shtet duhet ta ketë ushtrinë e vet dhe Kosova nuk është ndryshe nga vendet e tjera", ka thënë kongresisti amerikan. Eliot Engel gjithashtu mbështeti edhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për taksën 100% ndaj Serbisë. "Po ashtu këtë javë kishte disa vështirësi, përfshirë taksat me Serbinë. Unë e përkrah të drejtën e Kosovës për t'i vendosur këto tarifa, të drejtën e kryeministrit për t'i vendosur këto taksa, sepse nuk

besoj që Serbia po i përmbush premtimet e saj që i ka bërë. Jam shumë i zemëruar me faktin se sa herë që Kosova po tenton të bëhet pjesë e organizatave ndërkombëtare, Serbia po tenton ta bllokojë. Kjo ndodhi me INTERPOL-in, dhe ndodhi edhe me organizatat tjera", tha ai. Engel tutje tha se Serbia duhet të dëshmojë njëherë paqen, sepse sipas tij Kosova po e dëshmon kohë pas kohe. Ndërsa sa i përket liberalizimit të vizave, ai u shpreh se tani është koha për BE-në t'ua jap liberalizimin e vizave kosovarëve dhe jo viti 2020.

Dedaj i dorëzoi letrat kredenciale te presidenti i Maqedonisë

SHKUP, 17 DHJETOR - Ambasadori i Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj, i ka dorëzuar letrat kredenciale te presi-

identi i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov. Gjatë këtij takimi presidenti Ivanov dhe ambasadori

Dedaj rikonfirmuan rëndësinë e bashkëpunimit bilateral dhe marrëdhënieve të mira në të gjitha

fushat e jetës, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë si shtete fqinje.



Është mbajtur takimi i tretë për Stabilizim Asociim ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian në Bruksel

BE-ja nuk arrin ta bindë Kosovën për heqjen e taksës ndaj Serbisë

Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian as të hënën nuk kanë arritur ta bindin Kosovën për ta hequr taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Madje takimi për MSA-në ndërmjet Kosovës dhe BE-së, i kryesuar nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, është përshkruar me tensione. Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka thënë se dialogu për normalizim në mes të Kosovës dhe Serbisë ka dalë nga binarët me diskutimin e idesë për korrigjim të kufirit dhe shkëmbimit të territorit



tivën evropiane nga ana e BE-së, Haradinaj ka thënë se Kosova është e vendosur për anëtarësimin në BE dhe vazhdon të punojë për ta arritur zbatimin e plotë të MSA-së. "Edhe pse Kosova zbatoi të gjitha 95 kriteret e paracaktuara, siç është konfirmuar nga Komisioni në muajin maj, përgjigja që marrim nga BE-ja është gjysmake dhe e pashpresë. Edhe përkundër angazhimit të plotë në Agjendën e Reformës Evropiane (ERA) dhe reformave të fuqishme të ndërmarra për ta fuqizuar sundimin e ligjit dhe institucionet e tij, Kosova ndihet e tradhtuar dhe e zhgënjyer nga BE-ja. Njerëzit tanë sprovohen përtej asaj që është e arsyeshme dhe e drejtë. Koha nuk është miku ynë. Duhet të shohim përprim konkret", ka deklaruar Haradinaj.

**EPOKA
ERE** Shqipëri HETEMI

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shfrytëzuar Këshillin e Tretë të Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së për ta shprehur pakënaqësinë për procesin e liberalizimit të vizave dhe procesin e dialogut me Serbinë. Pavarësisht prej tensioneve që kanë përshkruar këtë takim të kryesuar nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, palët nuk janë pajtuar për heqjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Megjithatë, në këtë takim kryeministri Haradinaj ka thënë se dialogu ka dalë nga binarët me diskutimin e idesë për korrigjim të kufirit dhe shkëmbimit të territorit. Ai ka thënë se kjo çështje e ka dëmtuar seriozisht kredibilitetin e ndërmjetësuesit dhe arritjet që janë bërë në kuadër të dialogut për normalizim. "Qeveria dhe unë asnjëherë nuk e kemi vënë në pikëpyetje rëndësinë e dialogut. Kjo është e vetmja rrugë përpara për Kosovën dhe Serbinë, që të bëhemi anëtarë të barabartë të familjes evropiane. Megjithatë, njëzet vjet pas luftës, dhjetë vjet pas pavarësisë, dhe

pesë vjet pas marrëveshjes së Brukselit, realiteti është se përparimi drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë minimal dhe, në fakt, tani ka dalë krejtësisht nga binarët, veçanërisht me diskutimin publik mbi idenë fatale të korrigjimit të kufirit dhe shkëmbimit të territorit; ka dëmtuar seriozisht kredibilitetin e ndërmjetësuesit dhe ka dëmtuar arritjet që kemi bërë në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja për më shumë se 7 vjet", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se kushdo që flet për kufijtë, territorin, apo çfarëdo korrigjimi është armik i Kosovës. "Më lejoni të theksoj edhe një herë unë si kryeministër dhe Qeveria e Kosovës kundërshtojmë fuqishëm dhe e refuzojmë këtë ide, e cila do të sjellë vetëm luftëra dhe tragjedi të reja në Ballkan. Kushdo që flet për kufijtë, territorin, apo çfarëdo korrigjimi tjetër për vendim tim, është armiku ynë. Si kryeministër, ndodhem këtu për t'ju ballafaquar me të vërtetën, realitetin dhe orientimin e vendit tim jo çfarë doni ju të dëgjoni, ose për çka jeni njoftuar nga dikush tjetër. Realiteti është se ne jemi shtet sovran, demokratik dhe shumetnik dhe, bazuar në këtë të vërtetë të

padiskutueshme, ne duam të arrijmë një marrëveshje përfundimtare me Serbinë", ka theksuar ai. Haradinaj ka treguar se më 15 dhjetor Kuvendi i Kosovës ka votuar edhe delegacionin për dialog i cili do të bashkëkryesohet nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe lideri i PSD-së, Shpend Ahmeti. "Është delegacion gjithëpërfshirës me synimin që të përfshihen edhe palë të tjera. Ky është hap madhor në demokracinë tonë dhe i përgëzoj të gjithë deputetët e Kosovës që votuan delegacionin. Marrëveshja përfundimtare synon të sjellë paqe afatgjatë dhe të sigurojë të ardhme prosperuese evropiane për të dy shtetet. Përfshirja e Shteteve të Bashkuara në udhëheqjen e dialogut është kyçe, përdërisa BE-ja ofron garanci për ta mbushur hendekun e mundshëm midis dy vendeve. Le të jemi të sigurtë, të hapur dhe të drejtpërdrejtë në këtë mision", është shprehur kryeministri Haradinaj. Në këtë takim Haradinaj ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave dhe përmbushjen e reformave në

agjendën evropiane, duke thënë se Kosova ndihet e tradhtuar dhe e zhgënjyer nga BE-ja. Pavarësisht prej neglizhencës dhe mungesës së qartësisë për perspek-

Mogherini: Çështja e vizave për Kosovën po shqyrtohet

Shefja e Politikës së Jashtme e BE-së, Federica Mogherini, ka bërë me dije se vendimi mbi propozimin e Komisionit për liberalizim të vizave për Kosovën është duke u shqyrtuar në Këshill dhe në Parlamentin Evropian. "Sa i përket liberalizimit të vizave, Komisioni Evropian miratoi një raport në korrikun e vitit 2018 mbi përmbushjen e standardeve të mbetura. Vendimi mbi propozimin e Komisionit aktualisht është duke u shqyrtuar në Këshill dhe në Parlamentin Evropian", është thënë në komunikatën për medie të Zyrës së Mogherinit pas takimit të tretë për Stabilizim dhe Asociim mes BE-së dhe Kosovës që është mbajtur sot në Bruksel.

Shefja e Politikës së Jashtme e BE-së, Federica Mogherini, ka thënë se në këtë takim MSA-ja është çështja kyçe e marrëdhënieve mes BE-së dhe Kosovës. Sipas saj, kjo i ofron Kosovës një mundësi për përparim dhe afim të qëndrueshëm me Bashkimin Evropian, në përputhje me perspektivën evropiane të rajonit dhe krijon mundësi tregtie dhe investimi. Në takim, sipas kësaj komunikate, janë diskutuar zhvillimet e fundit kyçe

në lidhje me përmbushjen e kriterëve politike si dhe gjendjen aktuale në lidhje me kriteret ekonomike, bashkëpunimin financiar dhe zbatimin e MSA-së. BE-ja ka kërkuar heqjen e taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. "Bashkimi Evropian nënvizoi rëndësinë e zbatimit të vazhdueshëm dhe efektiv të MSA-së si dhe obligimet kontraktuale, përfshirë zonën e tregtisë dhe të doganës. BE-ja ka shprehur keqardhje të thellë për ngritjen e njëanshme qeveritare të taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina si dhe imponimin e barrierave jotarifore dhe insistoi në heqjen e tyre të menjëhershme. Futja në fuqi e këtyre tarifave dëmton interesat ekonomike të Kosovës dhe popullit të saj, duke ulur rrjedhën tregtare dhe dëmtuar atraktivitetin e Kosovës si vend për investime dhe biznes. Çdo pengesë për tregtinë duhet të zgjidhet brenda forumeve dhe mekanizmave të përshatshëm, me pjesëmarrjen konstruktive të të gjitha palëve të interesuara, në frymën e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore", është thënë në komunikatën e zyrës së Mogherinit.



Një muaj paraburgim ndaj të dyshuarve për vrasjen e Ivanoviçit

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji ndaj tre të dyshuarve për vrasjen e politikanit serb, Oliver Ivanoviç. Në një komunikatë për media të kësaj gjykate, thuhet se pas "seancës dëgjimore, pas marrjes së

aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës për rivendosje, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për caktimin e masës së paraburgimit kundër dytë pandehurve për shkak të veprës penale vrasje e rëndë dhe njërit për shkak të veprës penale zbulimi i fshehtë-

sisë zyrtare". Policia e Kosovës, me kërkesë të Prokurorisë Speciale, në muajin nëntor arrestoi katër persona në veri të Mitrovicës, tre prej të cilëve janë të dyshuar se kanë lidhje me vrasjen e politikanit serb Ivanoviç. Një person i katërt, po ashtu i dyshuar në lidhje me këtë rast,

mbetet ende në kërkim. Ndërkaq më 6 dhjetor Gjykata e Apelit e Kosovës ua ka zgatur masën e paraburgimit të pandehurve, N. S. dhe M. R., të dyshuar për vrasjen e politikanit serb, Ivanoviç si dhe të pandehurit D. M. për veprën "zbulim i fshehtësisë zyrtare".

Tre të dyshuarit për vrasjen e politikanit serb, Oliver Ivanoviç, të hënën kanë dalë edhe një herë para gjykatës ku "është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji për secilin veç e veç, nga data 23. 11. 2018 deri më datë 23. 12. 2018", thuhet në komunikatë.

Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

Delegacioni shtetëror për dialog



Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka bërë me dije se për fazën finale të dialogut me Serbinë, Kosovës i duhet një delegacion gjithëpërfshirës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se delegacioni i votuar në Kuvendin e Kosovës nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm për ta përfaqësuar Kosovën në këtë proces. Sipas Tahirit, legjitimiteti i nevojshëm do të arrihej vetëm me përfshirjen në delegacion edhe të dy partive më të mëdha opozitare, LDK-së dhe LV-së. Ndonëse ka mirëpritur miratimin e rezolutës për dialogun, ajo nuk pajtohet as me bashkëkryesimin e delegacionit nga Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj

EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka mirëpritur miratimin e rezolutës në Kuvendin e Kosovës për dialogun me Serbinë, por jo edhe përbërjen e delegacionit negociues.

Ajo ka thënë se delegacioni i Kosovës me përbërjen aktuale nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm për ta përfaqësuar

Kosovën në këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se pa përfaqësuesit e dy subjekteve më të mëdha opozitare, LDK-së dhe LV-së, legjitimiteti i këtij delegacioni do të jetë i brishtë. "Për një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kosova duhet të ketë një delegacion që shpreh legjitimitetin e plotë të përfaqësuesve. Mungesa e përfaqësuesve të dy partive më të mëdha opozitare

në këtë delegacion tregon se ky delegacion nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm. Madje mund të them se ky delegacion ka legjitimitet të brishtë, se pjesa më e madhe e votuesve shqiptarë janë me partitë opozitare", ka thënë Tahiri. Ajo ka shprehur kritika edhe për udhëheqësit e delegacionit, duke thënë se ata vijnë nga subjekte politike të vogla. "Dy bashkëkryesuesit janë nga partitë minore, të vogla. Pra, Nisma është një parti

e vogël, kurse PSD-ja jo që është parti e vogël, por ky subjekt politik ende nuk e ka matur legjitimitetin e vet qytetar. Pra, nuk janë bërë zgjedhjet për të parë nëse PSD-ja ka legjitimitet apo jo. Për bisedime me karakter historik në mes të Kosovës dhe Serbisë, delegacioni i Republikës së Kosovës duhet të ketë legjitimitet të plotë dhe unitet të gjerë mes shqiptarëve", është shprehur Tahiri. Ajo ka deklaruar se koalicioni qeverisës është dashur të bëjë më shumë përpjekje për ta bërë pjesë të këtij delegacioni LDK-në e LV-në.

Megjithatë, ish-ministrja Tahiri ka përmendur të mirat e rezolutës për dialog të miratuar në Kuvendin e Kosovës në fund të javës së kaluar. "Ana pozitive e kësaj rezolute është se aty ekziston formulimi se është kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës. Po ashtu, përmendja në rezolutë e njohjes reciproke

në mes të dy shteteve është me vend, sepse vetëm njohja reciproke mes dy vendeve mund të sjellë një paqe të qëndrueshme dhe një fqinjësi mes dy shteteve", ka deklaruar Tahiri.

"Epoka e re": *Znj. Tahiri, më në fund Kuvendi i Kosovës ka miratuar një rezolutë për dialogun me Serbinë. Cili është komenti juaj për këtë dokument?*

Tahiri: Nuk e kam parë versionin zyrtar të kësaj rezolute sepse jam jashtë Kosovës. Mirëpo aq sa kam lexuar përmes medieve, e shoh si pozitive nxjerrjen e kësaj rezolute. Ky dokument mbyll rrugën e temës së kufijve që të diskutohen në Bruksel dhe është një vendim shumë i rëndësishëm sepse këtë vit Kosova ka qenë e sfiduar me këtë çështje nga vetë zonja Mogherini, e cila lejoi që të diskutohet tema e kufijve në Bruksel, duke shkelur mbi parimet evropiane.

s'ka legjitimitet të mjaftueshëm



Në këtë drejtim edhe presidenti ynë bëri gabim duke pranuar që të diskutojë për këtë temë, ndërsa Serbisë i konvenon kjo temë sepse ajo u përpoq që gjatë këtij viti ta krijojë Serbinë e madhe në dëm të tokave të Kosovës. Pra, ana pozitive e kësaj rezolute është se aty ekziston formulimi se është kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës. Po ashtu përmendja në rezolutë e njohjes reciproke në mes të dy shteteve është me vend sepse vetëm njohja reciproke mes dy vendeve mund të sjellë një paqe të qëndrueshme dhe një fqinjësi mes dy shteteve. Dëgjova që rezoluta kishte edhe një draft-dokument për negociatë, por këtë nuk e kam parë dhe nuk dua ta komentoj më shumë.

"Epoka e re": Kjo rezolutë parasheh edhe përbërjen e delegacionit të Kosovës, ku janë të përfshirë përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës?

Tahiri: Mendoj se faza finale e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të nxjerrë një marrëveshje historike në mes të dy shteteve. Kjo marrëveshje historike mund të ketë rëndësi vetëm nëse sjell njohjen reciproke në mes të dy shteteve, si dhe respektimin e integritetit territorial dhe sovranitetit të dy vendeve. Për një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kosova duhet të ketë një delegacion që shpreh legjitimitetin e plotë të përfaqësuesve. Mungesa e përfaqësuesve të dy partive më të mëdha opozitare në këtë delegacion, tregon se ky delegacion nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm. Madje mund të

them se ky delegacion ka legjitimitet të brishtë, sepse pjesa më e madhe e votuesve shqiptarë janë me partitë opozitare. Qeveria, edhe pse ka menduar se po bën mirë duke u nxitur të krijojë këtë mekanizëm, në fakt ka bërë gabim sepse nuk ka arritur të ndërtojë një unitet kombëtar, politik dhe funksional për një delegacion i cili do të përfaqësojë legjitimitet të plotë. Së dyti, nuk është në pyetje vetëm legjitimiteti demokratik, sepse marrëveshja që del nga procesi i Brukselit duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës si marrëveshje ndërkombëtare. Dhe të gjithë e dimë se duhen dy të tretat e votave në Kuvend për miratimin e kësaj marrëveshje. Pra, mendoj se ka mangësi në këtë qasje dhe në këtë delegacion.

"Epoka e re": Delegacioni do të bashkëkryesohet nga Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj. Si e keni parë këtë formulë të përfaqësimit?

Tahiri: Dy bashkëkryesuesit janë nga partitë minore të vogla. Pra, Nisma është një parti e vogël, kurse PSD-ja jo që është parti e vogël, por ky subjekt politik ende nuk e ka matur legjitimitetin e vet qytetar. Pra, nuk janë bërë zgjedhjet për të parë nëse PSD-ja ka legjitimitet apo jo. Për bisedime me karakter historik në mes të Kosovës dhe Serbisë, delegacioni i Republikës së Kosovës duhet të ketë legjitimitet të plotë dhe unitet të gjerë mes shqiptarëve. Gabimin tjetër që e ka bërë Qeveria është se ka vendosur opozitën para aktit të kryer. Në këtë mënyrë gati ia ka mbyllur rrugën

opozitës për të marrë pjesë në këtë proces. Tashmë Qeveria ka dalë me rezolutë, me delegacionin e saj dhe me bashkëkryesuesit. Pra, Qeveria nuk ka treguar se ka qasje vizionare në këtë drejtim. Mirëpo e mira e kësaj pune është se kryeministri Haradinaj dhe Qeveria i është kthyer dialogut. Siç jeni të njohur, në fillim të mandatit kjo Qeveri dhe ky kryeministër thanë se nuk merren me procesin e dialogut të Brukselit. Dhe në këtë mënyrë jo vetëm se shkelen mandatin e dhënë nga Kuvendi i Kosovës, por në një mënyrë i hapen rrugën edhe temës së kufijve. Hapjes së temës nga presidenti për çështjen e kufijve i ka ndihmuar edhe Qeveria duke hequr dorë nga procesi i dialogut. Në këtë drejtim, gjatë këtij viti dëmet janë bërë tashmë jo vetëm në planin e brendshme që ka përçarë skenën politike, por edhe në planin ndërkombëtar janë bërë dëme, sepse duke folur për kufijtë e shtetit tonë, kemi vënë në dilemë jo vetëm shtetet që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, por edhe këto që e kanë njohur shtetin tonë. Madje për shkak të kësaj një pjesë e këtyre shteteve nuk na votuan edhe në Interpol.

"Epoka e re": Dy subjektet më të mëdha opozitare i kanë të garantuara vendet në këtë delegacion, por ato kategorikisht po refuzojnë të bëhen pjesë e këtij procesi pa shkuar në zgjedhje të reja.

Tahiri: Vetë fakti se dikush duhet t'i bashkohet këtij ekipi tregon se është mungesë e frymës së partneritetit. Këtu nuk kemi të bëjmë me një proces zgjedhor

pozitë dhe opozitë. Këtu duhet të gjithë së bashku, me partneritet dhe bashkëpunim, të shkojnë në bisedime me ish-armikun. Pra, pikërisht kur dikujt i thuhet bashkohu, i tregon se nuk e njeh si partner të barabartë. Derisa në raporte të brendshme raporti është i qartë, një palë është Qeveria, pala tjetër është opozita. Përballë Serbisë dhe në bisedime të gjithë janë të njëjtë, sepse atje do të shkojnë ta mbrojnë interesin shtetëror dhe kombëtar. Po të kishte lidhshmëri vizionare kjo Qeveri do të bënte çmos që të krijonte një delegacion gjithëpërfshirës.

"Epoka e re": Në anën tjetër, ShBA-ja, BE-ja dhe partnerët e tjerë të Kosovës e kanë përkrahur miratimin e kësaj rezolute, pavarësisht prej kundërshtimit të fortë të dy partive të tjera opozitare?

Tahiri: Ata e kanë përsëritur sepse e kanë parë përkushtimin e shtetit tonë për dialog, por ajo që po më pyetni mua ka të bëjë me politikën tona të brendshme. Partnerët tanë ndërkombëtarë merren me politikën të jashtme të Kosovës dhe si politikë e jashtme ne duhet të tregojmë se jemi për dialog. Kurse në politikën e brendshme ne duhet të dimë se kur e fituam këtë luftë për liri e pavarësi, e fituam se ishim të gjithë bashkë si shqiptarë. Unë hapur po ftoj në një unitet të shumicës shqiptare të përfaqësuar në delegacionin e Republikës së Kosovës. Këto janë politika tona të brendshme strategjike që ne duhet t'i kemi parasysh dhe duhet të jemi të zotë për t'i bërë ato.

Kurti kritikon propozimin e Qeverisë për marrëveshjen gjithëpërfshirëse me Serbinë

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka kundërshtuar draft-marrëveshjen përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë të paraqitur ditë më parë nga kryeministri Ramush Haradinaj. Kurti në një konferencë për media të hënën ka thënë se për Lëvizjen Vetëvendosje ky material në formën, mënyrën, qasjen dhe përmbajtjen e tij është i papranueshëm dhe nuk do të duhej që të dalë jashtë kabinetit të kryeministrit apo të atyre që e shkruan këtë dokument. "Fjala reciprocitet nuk figuron askund në këto 30 faqe, është një qasje e gjuhës së ndërmjetësuesit. Nëse do ta kisha lexuar pa emrin e shkruarit, do të mendo-

ja se këtë letër e ka shkruar ndonjë shtet që nuk e njeh Kosovën, e jo Qeveria e Kosovës. Rreth 50 pika apo paragrafë shprehimisht i drejtohen Kosovës dhe vetëm disa sosh i referohen butësisht Serbisë", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se nëpërmjet një marrëveshje të tillë Serbia do ta sigurojë "Zajednicën" brenda Kosovës. "Problemi kryesor i mënyrës së bërjes së këtij dokumenti është që ai parasheh themelimin e një morie trupash, komisionesh e ekipesh të përbashkëta midis Kosovës e Serbisë që, në fakt, e rilegjitimon praninë funksionale të Serbisë në Kosovë", ka theksuar Kurti. Ai ka thënë se në letrën e kryeministrit thuhet se çështjet

e hapura me Serbinë që kërkojnë trajtim dhe zgjidhje do të përmbillen me njohjen reciproke. "Pra, njohja në fund. Ky është shërbimi i madh Serbisë. Kërkesa jonë e parë është njohja, e ky i thotë Serbisë që kjo vjen në fund. Në fakt, nuk vjen as në fund, sepse në fund kërkohet veçse ulësja në OKB, përkatësisht anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Por asgjë brenda nuk ka të bëjë me reciprocitetin pastaj. Pra, s'do mend që në këtë material nuk përmenden askund shqiptarët në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, shqiptarët në Serbi në përgjithësi. Nuk është e rastësishme që thuhet njohja pa e përmendur pavarësinë. Nuk



është e rastësishme që në faqe 24 thuhet se Kosova e Serbia do të kenë mision diplomatike të njëra-tjetra dhe jo ambasada", ka deklaruar Kurti. Sipas Kurtit, kjo marrëveshje të cilën e dëshiron Haradinaj me Serbinë, merret ekskluzivisht me serbët e Kosovës. "Për shembull me

kthimin e tyre, thua se nuk ikën njëherë shqiptarët e Kosovës prej Serbisë gjatë gjithë shekullit 20 e deri te viti 2000 kur u dëbuan nga veriu i Mitrovicës. Me këtë marrëveshje të kryeministrit, që fillimisht duket sikur një far Ahtisari plus, gjithsesi i shkruar sikur nga një shtet i cili nuk na ka njohur, në fund nuk do ta marrim njohjen e pavarësisë nga Serbia, por ajo do ta fitojë 'Zajednicën' brenda Kosovës. Shkëmbimit territorial të Thaçit që, në fakt, është ndarje e Kosovës, Haradinaj praktikisht do t'i kundërvihet me 'Zajednicën' që, në fakt, është bosnjëzim. Secili më keq se tjetri. Asnjëri s'janë zgjidhje. Të dy janë probleme", ka thënë Kurti.

Kapiteni Bujar Ferizi nderohet me dy çmime në shkollën ushtarake në ShBA

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kudo që po marrin pjesë në trajnime dhe shkollime jashtë vendit po arrijnë rezultate të shkëlqyeshme. Një ndër ta është edhe kapiten Bujar Ferizi, shef i Qendrës së Operacioneve në Forcën e Sigurisë së Kosovës, i cili ka përfunduar me sukses trajnimin "Kursi i kapitenëve për mbrojtje kimike" në shkollën e Mbrojtjes Kimike-Atomike dhe Biologjike (MKAB) në Fort Leonard Wood, në shtetin Missouri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ky kurs ka filluar më 10 korrik dhe ka përfunduar më 7 dhjetor 2018.

Oficeri i FSK-së, kapiteni Bujar Ferizi, gjatë shkollimit 22 javor, në shkollën e MKAB-së në ShBA, për paraqitje të dalluar akademike është nderuar me

çmimin "Student Ndërkombëtar Nderi", kurse për rezultate të shkëlqyera në testin fizik ka marrë çmimin "Njeriu i hekurt". Kursi për kapiten të karrierës përfshin përgatitjen e përgjithshme të oficerëve në fushën e MKAB-së, në aftësi udhëheqëse, teknike dhe taktike luftarake, procedura shtabore, doktrina të gjinive të kombinuara të ndërlydhura me procesin e vendimmarrjes ushtarake, punë grupore dhe aftësim në operacionet e detektimit dhe dekontaminimit të materieve kimike-atomike-biologjike dhe nukleare.

Kapiten Ferizi është oficeri i parë nga Kosova i cili përfundon trajnimin e mbrojtjes nga helmet kimike, atomike, biologjike dhe nukleare të nivelit Kapiten Karriere në "United States Army CBRN School".



Ministri Mustafa: Siguria e qytetarit, prioritet për institucionet e vendit



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) së bashku me Këshillin Ekzekutiv të Forumeve të Sigurisë në Bashkësi të Republikës së

Kosovës ka mbajtur të hënën takim të fundit për vitin 2018. Në këtë takim u diskutua për kapacitetet operacionale, për sfi-dat si dhe rekomandimet për

ngritjen e rolit të forumeve të sigurisë në bashkësi.

Takimin e hapi ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, i cili ka theksuar se qëllimi i institucion-

eve të vendit është fuqizimi i rolit të forumeve të sigurisë në bashkësi, që kjo të shërbejë si një qendër dinamike e cila do të ndihmojë në planifikimin e politikave parandaluese dhe proaktive me bazë të qytetari. "Një ndër prioritetet e Republikës së Kosovës është siguria, për çka Qeveria ka angazhim të vazhdueshëm për krijimin dhe ruajtjen e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e saj", ka thënë ministri Mustafa. Ai ka theksuar se me Strategjinë për Siguri në Bashkësi, si dhe Strategjinë e Policimit në Bashkësi, siguria e qytetarit është bërë prioritet për institucionet e vendit dhe njëkohësisht mundëson partneritetet përmes vetëdijesimit dhe adresimit të çështjeve të sigurisë. "Mundësia e qytetarit për të qenë proaktiv me politikën në interes

lokal është siguruar përmes forumeve të sigurisë nëpër komuna dhe kjo pjesëmarrje aktive kontribuon në siguri më të madhe në të gjitha dimensionet në nivel vendi", ka thënë ministri Mustafa. Në këtë takim ka folur edhe ambasadori i OSBE-së, Jan Braathu, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad, kryetarë të komunave, si dhe zyrtarë të këshillave komunale për siguri në bashkësi. Drejtori i Departamentit për Siguri Publike i MPB-së, Mensur Hoti, ka prezantuar raportin e përmbledhur me të gjeturat dhe konkluzionet lidhur me vlerësimin e kapaciteteve operacionale të forumeve të sigurisë në bashkësi në të gjitha komunat. Ky takim është mbështetur nga misioni i OSBE-së në Kosovë.

Bahtiri paralajmëron peticion të qytetarëve për bashkimin e Mitrovicës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

MITROVICË, 17 DHJETOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se vendimi unanim i marrë nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës më 30. 11. 2018, duke iu drejtuar Qeverisë së Kosovës për të proceduar në Kuvendin e Kosovës kërkesën për bashkimin e qytetit të Mitrovicës, është legjitime. "Konsiderojmë se është shumë legjitime për vetë faktin se Kuvendi Komunal ka të drejtë t'u drejtohet organeve shtetërore me çfarëdo kërkesë.

Është organi kompetent të cilit Kuvendi Komunal i është drejtuar, Qeverisë së Kosovës dhe jo MAPL-së, ndërsa Qeveria e Kosovës në këtë rast është aktori kryesor që është dashur të kthejë një përgjigje për kërkesën tonë", është thënë në reagimin e Bahtirit dërguar mediave.

Ai në këtë reagim ka thënë se MAPL-ja nuk ka të drejtë ta shqyrtojë në brendësi kërkesën e tyre për arsye se nuk i është drejtuar këtij institucioni, pasi kërkesa i është drejtuar Qeverisë së Kosovës. "Ju pa të drejtë keni stopuar kërkesën tonë drejt rrugës së



Qeverisë së Kosovës e kjo nënkupton një frymë politike dhe aspak profesionale. MAPL-ja e cila monitoron edhe kuvendet komunale për vendimet e marra dhe në bazë të ligjit kthen edhe konfirmimet për ligjshmëritë e vendimeve, por nuk ka të drejtë të stopojë ligjërisht një kërkesë e cila i adresohet një organi tjetër për shqyrtim pa e shikuar thellësinë e kërkesës. Prandaj kërkoj profesionalizëm dhe paañesi politike që kjo kërkesë të delegohet tek organi i duhur shqyrtues", ka deklaruar Bahtiri. Ai ka shtuar se nuk do të ketë organ që do ta ndalë iniciativën

dhe vullnetin e mirë të qytetarëve të Mitrovicës që kjo kërkesë të delegohet tek organet kompetente të thirrura për miratimin e ligjeve të Kosovës. "Po ju paralajmëroj që nëse kjo kërkesë pengohet joligjërisht atëherë do t'u drejtohem qytetarëve për realizimin e një peticioni i cili do të ketë me qindra e mijëra nënshkrime. Këtë gjë nuk kam dashur ta bëj më herët sepse unë kam zgjedhur mënyrën institucionale ku përmes Kuvendit Komunal, i cili përfaqëson edhe zërin e qytetarëve, këtë kërkesë e kemi adresuar tek institucionet qendrore", ka thënë Bahtiri.

Fillon aplikimi për legalizimin e armëve ilegale

Për gjashtë muaj do të jetë në fuqi vendimi për legalizimin e armëve të vogla dhe të lehta që është nxjerr nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Koordinatori Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka, ka treguar për procedurat që duhen t'i ndjekin qytetarët për të realizuar këtë të drejtë ligjore



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Nga dita e hënë ka filluar aplikimi për legalizimin e armëve ilegale në Kosovë. Për këtë proces ka folur zëvendësministri i Punëve të Brendshme, i cili është edhe Koordinator Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka. "Vendimi për legalizimin e armëve të vogla dhe të lehta tanimë është nxjerr nga MPB-ja dhe periudha e legalizimit fillon nga sot, 17 dhjetor 2018, dhe do të jetë në fuqi për gjashtë muaj. Konsiderojmë se kjo periudhë është e mjaftueshme që qytetarët tanë t'i legalizojnë armët e veta. Gjatë kësaj kohe ne do t'i shpërndajmë në mënyrë të vazhdueshme informatat e nevojshme në lidhje me procedurat që duhen ndjekur nga qytetarët për të realizuar këtë të drejtë ligjore", ka thënë Zeka. Ai ka treguar edhe për procedurat që duhen ndjekur në këtë proces. "Në parim procedurat janë të thjeshta dhe krejt çka duhet të bëjë një qytetar i cili ka një armë dhe dëshiron ta legalizojë atë, duhet të lajmërohet te zyrtari policor në stacionin më të

afërt të policisë dhe aty do të marrë të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me procedurat që duhen ndjekur për ta legalizuar armën që ka në posedim. Përveç kësaj, ne si MPB do të jemi të gatshëm që të asistojmë në çdo kohë që paraqitet nevoja për të lehtësuar këtë proces", ka thënë ai.

Zëvendësministri Zeka ka theksuar se Kosova ballafaqohet me problemin e posedimit ilegal të armëve të vogla dhe të lehta kryesisht si vend i cili ka dalë nga lufta. "Kjo ka bërë që në duart e qytetarëve të mbetet një numër i madh i armëve të vogla dhe të lehta. Hulumtimet ndërkombëtare kane nxjerrë si rezultat që në Kosovë gjenden një numër në mes të 240 000 dhe 260 000 i armëve të vogla dhe të lehta. Ky numër është ulur për rreth 10 000 armë të vogla dhe të lehta gjatë viteve të kaluara si rezultat i masave që janë marrë nga institucionet, siç janë miratimi i bazës ligjore për armë si dhe konfiskimet e rregullta që bëhen nga Policia e Kosovës", ka thënë Zeka.

Ai ka shtuar se numri i armëve të vogla dhe të lehta në posedim ilegal që i referohen hulumtimet

është i madh. "Procesi i legalizimit është dizajnuar si i tillë që të ndikojë në uljen e këtij numri të armëve të vogla dhe të lehta. Ne kemi përgatitur dhe dërguar për miratim ligjin për legalizim dhe dorëzim vullnetar duke u bazuar në trendet e shteteve të rajonit si dhe kërkesat e vazhdueshme nga qytetarët të cilët kanë kërkuar krijimin e mundësisë që t'i legalizojnë armët që i kanë në posedim, duke mos u ndëshkuar për to. Gjithashtu, ky proces është kërkuar nga shoqëria civile si dhe ekspertët e sigurisë si domosdoshmëri për të ndikuar në uljen e numrit të armëve të vogla dhe të lehta në

posedim ilegal", është shprehur Zeka.

Ai ka theksuar se procesi i legalizimit të armëve të vogla dhe të lehta është një mundësi e mirë për poseduesit e armëve të vogla dhe të lehta ilegale, pasi siguron ata që nëse kanë armë dhe dëshirojnë t'i mbajnë, t'i regjistrojnë ato sipas kërkesës ligjore, duke mos pasur frikën se mund të ndëshkohen për to. "U bëjmë thirrje ta shfrytëzojnë këtë mundësi ligjore për t'i legalizuar armët e tyre. Gjithashtu, ky proces do të ndikojë edhe në përmirësimin e imazhit të vendit tonë, sepse ne kemi një numër të vogël të armëve të regjistruara

krahasuar me numrin e armëve të vogla dhe të lehta ilegale i cili del si rezultat i hulumtimeve të kryera. Pra, nga legalizimi përfitojnë të dyja palët dhe si rezultat final ne do të kemi një vend dhe mjedis më të sigurt për të jetuar", ka thënë zëvendësministri Zeka. Ai ka thënë se duke qenë se procesi i legalizimit po ndodh për herë të parë në Kosovë, kërkojnë mirëkuptim nga qytetarët për pengesat e mundshme teknike që mund të ndodhin. "Do të angazhohemi maksimalisht që ky proces të zhvillohet sa më mirë që është e mundur", ka thënë Koordinatorin Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka.

QKSS-ja: 15 për qind e qytetarëve thonë se dialogun duhet ta udhëheqë presidenti Thaçi



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) të hënë ka publikuar edicionin special të Barometrit Kosovar të Sigurisë me perceptimet mbi politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë. Sipas të dhënave të këtij barometri, 15 për qind e qytetarëve të anketuar kanë

thënë se dialogun Kosovë - Serbi duhet ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçi. Kurse 11.5 për qind e qytetarëve mendojnë se këtë proces duhet ta drejtojë lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti. Ndërsa 5.71 për qind e të anketuarve vlerësojnë se Kuvendi duhet ta udhëheqë dialogun, kurse 4.24 për qind

kanë sugjeruar që këtë ta bëjë Qeveria.

Shumica e të anketuarve mendojnë se shkëmbimi i territoreve nuk do të ofrojë zgjidhje afatgjatë ndërmjet dy vendeve. Ata kanë thënë se Serbia po përfiton më shumë se Kosova në dialog. Ndërkaq 80 për qind e të anketuarve besojnë se Asociacioni i

Komunave me Shumicë Serbe përbën rrezik të drejtpërdrejtë për funksionimin e brendshëm të Kosovës.

Gjysma e të anketuarve besojnë se Qeveria nuk po ndjek me sukses agjendën e saj të integritimit në BE. Mbi 82 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se janë pro anëtarësimit në NATO.

Po sipas rezultateve të këtij barometri, Shqipëria perceptohet si vendi më miqësor ndaj Kosovës, partner dhe aleat kryesor strategjik në politikën e jashtme. Kroacia është renditur si partnerja e dytë dhe perceptohet si aleatja kryesore brenda BE-së.

Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina janë vlerësuar si vende mike, kurse Serbia konsiderohet vendi më armiqësor ndaj Kosovës.

Mbi 86 për qind e qytetarëve besojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë partneri kryesor strategjik i Kosovës, duke kërkuar përfshirjen e tyre në dialog. Gjermania është perceptuar si aleatja kryesore strategjike brenda BE-së, kurse Britania e Madhe dhe Turqia janë vlerësuar si partnere miqësore. Ndërsa Franca është perceptuar kryesisht neutrale. Kurse Rusia është perceptuar si vend shumë armiqësor ndaj Kosovës.

Halimi: MBPZhR-ja, investime në zhvillimin e fermave të vogla

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), kanë organizuar të hënën punëtorinë "Zhvillimi i kapaciteteve të MBPZhR-së për përmirësimin e komercializimit ndërmjet fermerëve të vegjël dhe fermerëve ekzistencialë". Në këtë punëtori janë prezantuar analiza për zhvillimin dhe avancimin e fermave të vogla përmes të cilave janë paraqitur mënyrat më të mira të mundshme për përmirësimin e komercializimit ndërmjet fermerëve të vegjël dhe fermerëve ekzistencialë. Krahas kësaj, janë prezantuar edhe politikat zhvillimore dhe investimet e MBPZhR-së për mbështetjen e fermave të vogla. Me këtë rast, sekretari i përgjithshëm i MBPZhR-së, Kapllan Halimi, ka

treguar se kjo ministri me politikat strategjike ndërsektoriale dhe në harmoni të plotë me politikat e përbashkëta bujqësore të Bashkimit Evropian, është e orientuar për rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe për krijimin e kushteve sa më të favorshme për prodhuesit vendorë, në mënyrë që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm që vendi t'u bashkëngjitet trendëve zhvillimorë të vendeve të BE-së. "Ministria e Bujqësisë në programet e saj mbështetëse investimet i ka të orientuara edhe në fermat e vogla dhe përmes këtyre investimeve synojmë që në të ardhmen t'i rrisim aftësitë konkurruese të fermave në prodhimtarinë bujqësore si dhe t'i përmirësojmë kushtet e punës në këto ferma. Investimet në ferma dhe agropërpunim janë jetike për ta avancuar dhe për ta komercial-



izuar sektorin e bujqësisë, duke e shtyrë të orientohej gjithnjë e më shumë drejt kërkesave të tregut", ka thënë Halimi. Ndërsa u. d. i kryeshefit të

Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, Ekrem Gjokaj, ka thënë se përmes implementimit të Programit për Pagesa Direkte dhe Programit për Bujqësi dhe

Zhvillim Rural të këtij viti kanë arritur të përkrahin numër të madh të fermerëve në vend si dhe një numër të madh të agrobizneseve.

Reçica: Personat e riatdhesuar do të kenë mbështetje socio-ekonomike



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka nënshkruar të hënën marrëveshjen e bashkëpunimit me Caritasin zviceran në kuadër të projektit "SUREP", i cili synon të kontribuojë në riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe familjeve të tyre në Kosovë përmes këshillimit dhe mbështetjes socio-ekonomike. Ai ka bërë me dije se ky projekt synon t'i mbështesë posaçërisht grupet e cenueshme të riatdhesuarve siç janë nënat e vetme me fëmijë, personat me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të kthyerit nga

zonat e konfliktit. "Sapo nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Caritasin zviceran në kuadër të projektit SUREP i cili synon të kontribuojë për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe familjeve të tyre në Kosovë përmes këshillimit dhe mbështetjes socioekonomike. Projekti është i rëndësishëm së veçantë ngaqë synon t'i mbështesë posaçërisht grupet e cenueshme të riatdhesuarve siç janë nënat e vetme me fëmijë, personat me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të kthyerit nga

Në Kosovë janë 43 këmbimore

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Në tërë territorin e Republikës së Kosovës deri në nëntor të këtij viti figurojnë të regjistruara në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) 43 këmbimore të cilat në veprimtarinë e tyre kanë shitblerjen e valutave të huaja në para të gatshme.

Zëdhënësi i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Kushtrim Ahmeti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se numri i këmbimoreve të regjistruara në Bankën Qendrore të Kosovës kap shifrën mbi 40 sosh. "Numri i këmbimoreve të

regjistruara në BQK deri në muajin nëntor të këtij viti është 43 sosh", ka thënë Ahmeti. I pyetur se si funksionojnë dilertët, të cilët nëpër rrugët e Prishtinës i këmbajnë paratë në duar, Ahmeti ka theksuar se çdo aktivitet këmbimor që bëhet pa qenë i licencuar në BQK është i paligjshëm. Sipas manualit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, "institucion financiar jobankar (IFJB) - person juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është regjistruar nga BQK-ja sipas Ligjit për Bankat, IMF dhe

IFJB, për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese duhet ta ketë: dhënien e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënieje financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutë; kreditëkartat; faktoringun ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operacionale, si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja".



OEAK-u: Prokurimi publik me zhvillime të reja për transparencë më të madhe

Në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) të titulluar "Prokurimi publik në zhvillim të vazhdueshëm" është bërë me dije se bizneset jo rrallëherë kanë shprehur shqetësimet e tyre përkitazi me aktivitetet e prokurimit publik. Drejtori ekzekutiv i OEAK-ut, Arian Zeka, vlerësuar si pozitive zhvillimet e reja në këtë fushë të cilat janë mundësuar falë gatishmërisë së institucioneve përkatëse dhe mbështetjes konkrete të programeve të USAID-it

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Risi të shumta janë prezantuar në fushën e prokurimit publik në Kosovë, me qëllim të lehtësimit të procedurave të aplikimit, rritjes së transparencës dhe lehtësimit të qasjes në të dhënat publike. Kjo u tha në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë të titulluar "Prokurimi publik në zhvillim të vazhdueshëm". Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se bizneset jo rrallëherë kanë shprehur shqetësimet e tyre përkitazi me aktivitetet e prokurimit publik, duke vlerësuar si pozitive zhvillimet e reja të cilat janë mundësuar falë gatishmërisë së institucioneve përkatëse, por edhe mbështetjes konkrete të programeve të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim

Ndërkombëtar (USAID). Stephen Carpenter, udhëheqës i ekipit, Aktiviteti i USAID-it për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse në Kosovë, ka thënë se publikimi i plotë i kontratave të tenderëve në sistemet elektronike për opinionin e gjerë rezulton në transparencë më të madhe, ndërsa zhvillimi i sistemi të prokurimit elektronik që përfshin të gjitha procedurat nga shpallja e ofertave deri të përzgjedhja e operatorëve ekonomikë zvogëlon kontaktin fizik ndërmjet operatorëve dhe autoriteteve kontraktuese. Ai ka vlerësuar si inkurajues gatishmërinë e komunave për bashkëpunim në këtë drejtim, ndërsa duke folur për transparencën në rritje, ai ka treguar edhe për ndihmën që i është dhënë Organit të Shqyrtimit të Prokurimit, që do ta mundësojë transmetimin përmes internetit të seancave dëgjimore të këtij organi.

Sami Uka, anëtar i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ka thënë se ky institucion ka punuar ngushtë me aktivitetin e USAID-it në mënyrë që ta zhvillojë më tej sistemin e prokurimit publik, njëkohësisht duke mundësuar rritjen e normave të transparencës përmes publikimit të të dhënave të procesit të prokurimit. Ai njëkohësisht

ka theksuar se KRPP-ja do t'i vazhdojë zhvillimet për t'i kontribuar një mjedisi më të mirë të prokurimit publik në vend. Ndërsa Blerim Dina, kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit, përmendi, mes të tjerash, zhvillimin e fundit të bërë nga ky institucion i cili mundëson transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të prokurimit, duke thënë se

përmes kësaj synohet rritja e transparencës dhe qasja më e afërt me operatorët ekonomikë. Ai ka thënë se OShP-ja është angazhuar për publikimin e vendimeve të lëshuara si dhe për zhvillimin e sistemit elektronik të ankesave, zhvillime këto të cilat janë reflektuar edhe në rritje të numrit të ankesave të raportuara në këtë institucion.

Skender Komoni zgjedhet zëvendëskryesues i Bordit të Drejtorëve të AKP-së



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën, me rastin e skadimit të mandatit të zëvendëskryesuesit të Bordit, Bajram Zejnullahu, Bordi ka emëruar zëvendëskryesuesin e ri të Bordit të Drejtorëve të AKP-së,

Skender Komoni, mandati i të cilit fillon prej datës 17 dhjetor 2018. Bordi ka miratuar valën e re të shitjes së aseteve me nr. 44, e cila do të përmbajë asete nga rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës si dhe ka aprovuar transaksionet e valës së shitjes

me nr. 43. Në këtë mbledhje Bordi ka miratuar kërkesën e Komunës së Drenasit për dhënie të pëlqimit për lejimin e bartjes së një prone të ndërmarrjes shoqërore të Radiotelevizionit të Prishtinës në pronësi të Kuvendit Komunal Drenas në përputhje të vendimit


të Qeverisë për shpronësim. Gjithashtu, Bordi ka aprovuar propozimin për marrëveshje me Komunën e Prishtinës për pagesën me këste të mjeteve pasi të merret vendimi nga Qeveria për shpronësim të ndërmarrjes shoqërore "IMN Kosova". Po ashtu, Bordi i Drejtorëve i

AKP-së ka shqyrtuar dhe miratuar edhe raportet e komisioneve për qiradhënie të aseteve të NSh-ve si dhe janë shqyrtuar dhe miratuar edhe raportet rekomanduese të komisionit për asete specifike, si dhe për shitjen e aseteve përmes negociatave të drejtpërdrejta.

Prokuroria Themelore në Ferizaj për një javë ka ngritur 72 aktakuza

FERIZAJ, 17 DHJETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë javës së kaluar ka ngritur gjithsej 72 aktakuza dhe ka paraqitur gjashtë kërkesa për caktim të masës së paraburgimit. Në Departamentin e Krimeve të Rënda, gjatë javës së kaluar janë ngritur pesë aktakuza dhe janë bërë dy kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit. Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie ka ngritur

gjithej 61 aktakuza, ka bërë katër (4) kërkesa për caktim të paraburgimit dhe ka marrë tetë (8) aktvendime për fillim të hetimeve. Ndërsa Departamenti për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Ferizaj gjatë javës së kaluar ka ngritur gjashtë (6) aktakuza. Prokuroria Themelore në Ferizaj mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.



Fillon stabilizimi i Pallatit të Rinisë, paguhen pagat e punëtorëve


PRISHTINË, 17 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se ka filluar stabilizimi i Pallatit të Rinisë dhe punëtorët i kanë marrë pagat e tyre për dy muaj. Ai ka treguar se kjo ndërmarrje e cila tashmë është

në menaxhimin e Komunës së Prishtinës i ka mbi tre milionë euro. "Pas përfundimit të procedurave administrative, tashmë Pallati i Rinisë është në menaxhim të Komunës. Me këtë fillim edhe stabilizimin e ndër-marrjes e cila i ka mbi tre milion

euro borxhe. Të premtën kemi kaluar krizën e parë të pagave pas marrëveshjes me përmbartuesit që bllokojnë llogaritë. Janë pagur paga për dy muaj dhe vazhdojmë me hapat e tjerë", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Autostrada e Dukagjinit, projekt i rëndësishëm edhe për Rahovecin

RAHOVEC, 17 DHJETOR (ER) - Zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë projektuese kanë prezantuar të hënën tri variantet e projektit për Autostradën e Dukagjinit. Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se ky është një projekt shumë i rëndësishëm edhe për Rahovecin. "Në komunën tonë do të kalojë traseja dhe do të ketë qasje në autostradën që do ta lidhë rrafshin e Dukagjinit, nga Istogu deri në Prizren. Bashkë me ekipin tim jemi të angazhuar intensivisht që Rahoveci të përfitojë maksimalisht nga ky projekt, ku edhe i kemi shprehur sot nevojat dhe kërkesat tona të cilat do të mer-



ren parasysh. Së shpejti do të ketë edhe debat publik për këtë temë, ku edhe qytetarët do të

kenë qasje në projekt dhe t'i shprehin idetë dhe komentet e tyre", ka thënë kryetari Latifi.

Qendra për Punë Sociale në Klinë dhe shoqata 'Caritas Umbria' fillojnë bashkëpunimin



KLINË, 17 DHJETOR (ER) - Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Klinë, Ilir Bacaj, të hënën e ka pritur për një takim përfaqësuesin e "Caritas Umbria" që vepron në fshatin Leskoc të Klinës, Besart Bajraktari, ku kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit. Ky memorandum bashkëpunimi është vazhdimësi dhe ka për qëllim përmirësimin e veprimtarisë institucionale në kuadër të ofrimit të shërbimeve sociale në komunitet, rritjen e ndërgjegjësimit, lehtësimin e dialogut dhe nxitjen e bashkëpunimit në mes këtyre dy institucioneve për ofrim të shërbimeve sociale sa më cilësore për familjet në nevojë.

LDK-ja përkrah kërkesat e Rrjetit të Grave të Kosovës

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, së bashku me deputeten Vjosa Osmani dhe deputetin Armend Zemaj, kanë pritur sot në takim përfaqësueset e Rrjetit të Grave të Kosovës. Në këtë takim përfaqësueset e Rrjetit të Grave të Kosovës kanë paraqitur kërkesat e tyre buxhetore për shpenzimet e strehimoreve për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së

grave si dhe të fëmijëve që kanë përjetuar dhunë në familje. Me këtë rast shefit i grupit parlamentar, Avdullah Hoti, ka premtuar se kërkesa e tyre do të mbështetet në përputhje me ligjet në fuqi. Ky grup parlamentar do të paraqesë amendament në buxhetin e vitit 2019 për këtë kërkesë të Rrjetit të Grave të Kosovës dhe pret që kjo të mbështetet nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës.



Vendimet e guximshme i sjellin ndryshimet e mëdha



Nga Jakup KRASNIQI

Jam i bindur se të gjitha gjeneratat e ilegales, po të kërkohej nga prindërit e tyre, mbase me ndonjë përjashtim, për përfshirje në organizata revolucionare e çlirimtare, do ta merrnin një përgjigje: "Është punë e vështirë të luftosh me shtetin - Jugosllavinë e Titos dhe UDB-në rankoviqiste me zagarët e tyre!" Por, ata të ilegales nuk vepruan ashtu, ata nuk kërkuar, as pyetën, por vepruan fshehur të gjithëve, veç bashkëmendimtarëve të tyre të idealit! Ata kërkuar dhe pyetën vetëm ndërgjegjen e tyre, bindjet e tyre që i kishin krijuar nga realiteti i hidhur i robërisë, nga shëmbëlltyrat e tyre historike që i mbushnin me dashurinë për lirinë dhe dijet e fituara se asgjë nuk ndryshohet pa bindje, guxim, konsistencë e konsekuencë dhe,

mbi të gjitha, pa integritetin personal të secilit ilegalist.

Cili prind do t'i kërkonte Adem Demaçit t'i kalonte 30 vjet nëpër burgjet jugosllave? Edhe pse nëna i kishte thënë e përsëritur: "Nëna është e vdekshme, Shqipëria është e pavdekshme!". Por Adem Demaçi e nisi një rrugëtim pa u lëkundur dhe atij rrugëtimi sikurse edhe idealit të tij për çlirim e bashkim kombëtar iu qëndroi besnikërisht deri në fund të jetës së tij. Adem Demaçi në gjithë atë rrugëtim tregoi integritet ndër më të veçantët e gjithë brezit të tij duke u bërë kështu kryefrymëzuesi i gjithë luftëtarëve të Lëvizjes Kombëtare Ilegale për Çlirim e Bashkim Kombëtar.

Një maksimum thotë: "Të luftosh edhe mund të humbësh, por pa luftuar nuk ka fitore, nuk ka liri!" Nga kjo urti duhet të jenë udhëhequr shumë breza, të cilët edhe përjetuan shumë beteja jetësore, deri te ajo e Adem Legjendarit, i cili pos që pati një integritet të veçantë pati bindjen absolute se pa luftë e flimim nuk ka liri, nuk ka çlirim e bashkim kombëtar. Pa fije dyshimi, ai e pat një të veçantë, shok bindjeje

e lufte e pati Xha Shabanin, babanë e tij dhe gjithë familjen e tij, që në ditët tona pak kush do ta kuptojë këtë në përmasën e duhur! Përndryshe, me armikun shekullor, shtetin e Serbisë, kjo familje nuk do të luftonte në periudha të ndryshme, qysh nga 1991, për të kulmuar në janarin e 1998-s dhe përfundimisht marsin e 1998-s!

Por, duhet nënvizuar edhe këtë: Sikur Adem Legjendari të kërkonte apo të pyeste politikanët e Prekazit, të Drenicës dhe sidomos të Kosovës së kohës, se a duhej luftuar për liri, pa dyshim nga të gjithë, pa përjashtim, nga të gjithë do ta merrte një përgjigje: "Serbia është e fortë, armë e njerëz për këtë luftë nuk kemi. Serbia na shfaros me shtëpi e katandil!" E tillë ishte bindja e njerëzve që donin ta "çlironin" vendin pa luftë, i cili vend do të ishte "i hapur nga Serbia e Shqipëria"! Po kështu nuk mendoi Legjendari - Adem Jashari dhe Lëvizja Kombëtare për Çlirim që e mbështeti vazhdimin e luftës për liri. Sa mirë bënë që as nuk e kërkuar këtë e as nuk i pyetën pritësat!

Adem Legjendari luftën e filloi më 30 dhjetor 1991, ndërsa jetën e përmbylli me lavdi ndër më të veçantat në historinë jo vetëm të kombit tonë, por edhe në atë të përbotshmen! Legjendari lirinë s'e arriti e as e përjetoi, por pas një viti Kosova e tij u çlirua e më pas edhe shteti u pavarësua. Familja e tij është përtërirë me nipër e mbesa si drita diellore! Jasharët legjendarë ishin të bindur se Liria për një komb vjen vetëm atëherë kur pjesëtarët e tij s'i druhen vdekjes për komb e atdhe, siç e thotë një aforizëm qartë e bindshëm: Liria vjen kur s'i druhen vdekjes!

Lufta e tij çlirimtare, sakrifica e tij dhe kushtimi që i solli gjithë popullit të tij bënë që kombi ynë të fitojë miq të rinj me të cilët e bashkërenduan lirinë, pavarësinë dhe së fundi Ushtrinë e Kosovës! Nuk thuhet kot: "Miku i mirë për ditë të vështira!"

I thashë si më sipër, shkurt e shqip, kërkesën imediate, ngulmimin dhe përkushtimin shekullor, për të treguar se njerëzve e kombeve në jetën e tyre politike mund t'u falen shumëçka tjetër, por kurrë liria, pavarësia, sovraniteti.

Shumë zhvillime të reja që po ndodhin rreth në këtyre ditëve, përfshirë sidomos këto të fundit, rreth taksës 100 % dhe ushtrisë, konfirmojnë se për disa gjëra fundamentale, në mesin e tyre edhe shtetndërtimi, po u kërkuar apo të pyetet paskajshmërisht lidhur me veprimet e domosdoshme imediate as nga më të afërmit nuk të ketë izë dhe se këtë po e shohim si në pikun e ditës, e të mos flasim për sojin që ka interesa nga më të ndryshmet! Një gjë duhet pasur parasysh: janë interesat që po e udhëheqin botën dhe jo vetëm sot! Sepse ky fenomen nuk është vetëm i kohës sonë.

Botës dhe Evropës duhet t'u thuhet qartë: Edhe ne kemi të drejtën e ligjshme për liri, paqe e siguri si çdo komb e shtet në botë. Nuk janë ushtarët ata që rrezikojnë kombe e shtete, por janë politikantët luftënxitës e gjenocidale ndaj të tjerëve ato që kanë rrezikuar e rrezikojnë kombe e shtete.

E kaluara jo e largët na e dëshmon këtë.

Ndaj për proceset vendimtare duhen vendime e veprime për ndryshim e jo pritjet që të përgjumin e të shpien në pus të pafund!

Ministri Ismaili nënshkroi planin e imunizimit për vaksinimin e popullatës

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka nënshkruar të hënën Planin Strategjik të Imunizimit (PSI) 2019-2021, i cili ka për qëllim përfshirjen me imunizim të gjithë popullatës së Republikës së Kosovës për t'u mbrojtur nga sëmundjet që mund të parandalohen nëpërmjet vaksinimit si dhe sigurimin e mbulueshmërisë sa më të madhe me vaksinim.

Plani Strategjik i Imunizimit 2019-2021 është përpiluar si pjesë e reformës shëndetësore, bazuar në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021 si dhe ka për qëllim t'i përforcojë shërbimet e imunizimit, ta sigurojë qëndrueshmërinë financiare për prokurimin e vaksinave dhe mjeteve të tjera, pajisjet, ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë, edukimin dhe promovimin shëndetësor dhe prezantimin e vaksinave të reja në përputhje me rekomandimet e OBSH-së dhe UNICEF-it.

Qëllimi i këtij plani strategjik është ta sigurojë arritjen e mbulueshmërisë universale të imunizimit. "E dimë se imunizimi shpëton shumë jetë për çdo vit. Kjo është arritje e madhe në fushën e shëndetit publik dhe arritur e madhe edhe në Kosovë.

Ky plan strategjik është në përputhje me zhvillimet strategjike për përforcimin e shërbimeve shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë fëmijët e Kosovës", ka thënë ministri Ismaili me rastin e nënshkrimit të këtij plani. Ai ka thënë se nëpërmjet programeve të dëshmuara sikurse është ai i vaksinimit do të ndihmojnë dhe kontribuojnë për arritjen e agjendës për imunizim në nivel global si dhe për arritjen e synimeve zhvillimore të qëndrueshme.

Objektivi strategjik i këtij plani është ruajtja e shëndetit të popullatës nëpërmjet imunizimit, ndërsa kjo do të arrihet nëpërmjet objektivave specifike si avokimi për ta prioritetuar programin e imunizimit; ngritja e vetëdijes së individëve dhe komuniteteve për rëndësinë e imunizimit dhe vaksinimit; sigurimi i qasjes së barabartë në shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit për të gjithë; mbajtja dhe fuqizimi i shërbimeve të imunizimit dhe vaksinimit në kuadër të sistemit shëndetësor si dhe sigurimi i qëndrueshmërisë financiare për programin cilësor dhe teknologjinë inovative të imunizimit dhe vaksinimit



Imunizimi është një nga fushat e rëndësishme strategjike për shëndetin publik.

Kosova ka program të mirë të vaksinimit dhe ka raportuar shkallë të lartë të mbulueshmërisë që nga periudha e pasluftës me përfshirje rreth 95 për qind.

mërisë që nga periudha e pasluftës me përfshirje rreth 95 për qind.

Marrëveshja për Brexit do të dalë në votim në janar

LONDËR, 17 DHJETOR - Ligjvënësit britanikë do ta votojnë marrëveshjen për Brexit, apo daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, në javën që nis më 14 janar, tha kryeministria britanike Theresa May. Votimi është dashur të mbahet javën e kaluar, por është vënë në pritje pasi May e ka pranuar se do të humbasë. Duke shpallur datën e re, May tha se e përjashton

mundësinë për një referendum të ri rreth anëtarësisë së Britanisë në BE. "Votimi i ri do t'i bënte dëm të pariparueshëm integritetit të politikës sonë dhe nuk do ta zgjidhte çështjen", tha May para Parlamentit britanik. Ajo po lufton për t'i bindur ligjvënësit që ta pranojnë marrëveshjen e divorcit, që qeveria e saj ka arritur me Bashkimin Evropian muajin e kaluar.

Por, marrëveshja kundërshtohet nga politikanë të të gjithë spektrit politik, përfshirë ata të partisë së saj, Tory. Për të hyrë në fuqi, ajo duhet të mbështetet nga shumica e deputetëve të Parlamentit britanik, në të kundërtën Britania rrezikon të largohet nga BE-ja pa marrëveshje dhe në këtë mënyrë të pësojë rënie të madhe ekonomike.



Donald Trumpi i vë vulën politikës së jashtme amerikane

Kur Mike Pompeo mori detyrën e sekretarit të Shtetit në muajin maj, pas shkarkimit të Rex Tillersonit, ai premtoi ta ndihmojë agjencinë ta rifitojë sigurinë si dhe ta formësojë politikën e jashtme të presidentit Trump "Amerika e para"

WASHINGTON, 17 DHJETOR - Presidenti Donald Trump i shtoi detaje të reja doktrinës së tij politike "Amerika e para" në vitin 2018, me politika që synuan shkundjen e institucioneve të ngritura pas Luftës së Dytë Botërore.

Kur Mike Pompeo mori detyrën e sekretarit të Shtetit në muajin maj, pas shkarkimit të Rex Tillersonit, ai premtoi ta ndihmojë agjencinë ta rifitojë sigurinë si dhe ta formësojë politikën e jashtme të presidentit Trump "Amerika e para". Në një linjë me këtë, në një fjalim përpara një publiku thellësisht dyshues evropian, Pompeo tha se rendi ndërkombëtar pas Luftës së Dytë Botërore kishte tradhtuar si amerikanët ashtu edhe ata. "Kur traktatet nuk zbatohen, duhet të ballafaqohemi me shkelësit. Traktatet duhet të ndreqen ose të

prishen", tha ai. Në funksion të këtij qëllimi, Shtetet e Bashkuara, nën udhëheqjen e presidentit Trump, u larguan nga marrëveshja bërthamore me Iranin si dhe marrëveshja e Parisit mbi ndryshimet klimatike. Presidenti iu vu pas dhe një numri zyrtarësh të lartë. Për disa analistë, Trumpi po rikrijon një ekip më të bashkuar, në mbështetje të platformës së tij. "Aktualisht pas dy vitesh ai rrethohet me besnikë, me njerëz që janë të përkushtuar për të zbatuar vizionin e tij", thotë Celia Belin e Institutit Brookings. Takimi i nivelit të lartë mes presidentit Trump dhe udhëheqësit të Koresë së Veriut Kim Jong Un në Singapor qershorin e kaluar nuk ka dhënë ende rezultate konkrete. "Ndërsa ajo që rezultoi nga ato bisedime nuk dha



shumë, nga pikëpamja e thelbit, në vetvete fakti që këto bisedime u zhvilluan, ishte një arritje mjaft e madhe", thotë Luke Coffey i "The Heritage Foundation". Por Trumpi u kritikua ashpër lidhur me takimin e tij të muajit korrik me presidentin rus Vladimir Putin. Takimi u pa nga shumë si miratim i qëndrimit të Putinit mbi ndërhyrjen ruse në zgjedhjet amerikane të vitit 2016. "Pa dyshim do ta përshkruaja takimin e presidentit Trump me

presidentin Putin në Helsinki si pikën më të ulët të politikës së jashtme, jo vetëm përgjatë këtij viti, por të administratës Trump deri më tani", tha ai. Vrasja e gazetarit të "Washington Post" Jamal Khashoggi në Konsullatën saudite në Stamboll tronditi komunitetin ndërkombëtar javët e fundit. Por ndërsa e dënoi vrasjen, Trumpi tha se do të vazhdojë të qëndrojë me një aleat të rëndësishëm sikurse Arabia Saudite. Për disa analistë

ky qëndrim dërgon mesazh të gabuar te qeverisjet autoritare në mbarë botën. "Ai e tha qartë se interesat ekonomikë kanë më shumë rëndësi sesa vlerat morale", tha Celia Belin nga Instituti Brookings. Sa i takon Kinës, vëzhguesit po përgatiten për një konflikt të mundshëm vitin që vjen ndërsa dy vendet kanë mosmarrëveshje lidhur me tregtinë, detin e Kinës së Jugut dhe sigurinë kibernetike.

Kryeministri i Francës thotë se nuk i dëgjuam njerëzit



PARIS, 17 DHJETOR - Kryeministri francez Edouard Philippe ka pranuar se qeveria ka bërë gabime në mënyrën se si i ka trajtuar protestat masive të "Jelekeve të verdhë" që kanë kapluar vendin gjatë pesë javëve të fundit. "Ne bëmë gabime. Ne nuk e dëgjuam 'Mjaftin' e artikuluar nga populli francez. Mbetem i bindur se ata duan që ky vend të transformohet", tha ai. Dhuna në demonstrata ka prekur një nivel rekord me qin-

dra protestues të plagosur që nga 17 nëntori, teksa kanë vdekur edhe 7 shtetas gjatë protestave. Punonjësit e policisë kanë pësuar gjithashtu lëndime. Qytetet franceze janë përfshirë nga kaosi, me protestuesit që kanë shkatërruar dritaret e dyqaneve, kanë plaçkitur, përmbytur vetura dhe kanë djegur barrikada. Qendrat e qyteteve të mëdha kanë "humbur" në mjegull nga gazi lotsjellës, granatat dhe fishekzjarrët. Më parë në dhjetor, ministri i

Financave Bruno Le Maire pranoi se protestat ishin një "katastrofë" për ekonominë dhe bizneset e vendit. Njerëzit fillimisht protestuan kundër rritjes së çmimit të karburantit për shkak të hyrjes në fuqi të një takse të re këtë janar, ndërsa qeveria u detyrua të braktiset planin fillestar. Por demonstruesit vazhduan të kërkonin më shumë lëshime, duke përfshirë taksa më të ulëta dhe madje edhe dorëheqjen e Emmanuel Macron.

Rusia, Turqia dhe Irani flasin për Sirinë

GJENEVE, 17 DHJETOR - I dërguari special i OKB-së për Sirinë do të organizojë sot (e martë) një takim në Gjenevë me krerët e diplomacisë së Rusisë, Turqisë dhe Iranit, në

një përpjekje të fundit për të pajisur Sirinë me një Kushtetutë të fundit. Kjo mbledhje, e njoftuar nga zyra e tij, me shumë mundësi do të jetë e fundit për Staffan de

Mistura që do të largohet nga funksionet e tij në fund të vitit. Një zëdhënës i Ministrisë ruse të Punëve të Jashtme konfirmoi praninë e ministrit, Sergei Lavrov. Një burim diplomatik

turk njoftoi gjithashtu se ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu do të jetë i pranishëm, ashtu sikur ministri iranian i Punëve të Jashtme, Mohammad Javad Zarif.





E rrallë

Diplomon në moshën 84-vjeçare

Pasi rriti pesë fëmijë dhe doli në pension në moshën 77-vjeçare nga puna si sekretare, Janet Fein mori një vendim shumë të guximshëm. Fein iu rikthye shkollës dhe në moshën 82-vjeçare arriti synimin e saj duke marrë një diplomë bachelor nga Universiteti i Teksasit në Dallas. "Nuk kisha asgjë për të bërë kur dola në pension", ka thënë Fein, e cila u diplomua në sociologji.



FOTO E DITES



Ndërtesat në rrethin e kështjellës mbulohen nga dëborat në Budapest, Hungari. Fotografia realizuar nga: Balazs Mohai /AP/

E jashtëzakonshme

Zbulohet varri 4 400-vjeçar i ruajtur në gjendje fantastike në Egjipt

Një varr 4 400-vjeçar, i ruajtur në gjendje të mirë, është zbuluar në Egjipt. Varri, i zbuluar me hieroglifë shumëngjyrëshe dhe me statuja faraonësh, u gjet në jug të Kajros të shtunën. Ndërsa zyrtarët presin të zbulohet më shumë kur arkeologët t'i përfundojnë gërmimet në vend në muajt e ardhshëm.



BARSOLETA E DITËS



- Çfarë bërë sot?
- I mbyta dy miza, një femër dhe një mashkull.
- Si i dallove?
- Njëra kishte qenë te pasqyra, tjetra te shishja e rakisë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



DASHI

Po mendoni ndryshime radikale në të


ardhmen. Kjo nuk përfshin persona që ju kanë mbështetur këtë periudhë dhe që do të ndihen keq.



DEMI

Keni lejuar që personat pranë jush t'ju karikojnë me energji negative dhe kjo ditë nuk do të jetë aq e mirë dhe e gëzueshme sa zakonisht.

ri dhe kjo gjë do të ndikojë të mbylleni dhe të mos komunikoni shumë me të tjerët.



BINJAKËT

Nuk po gjeni vetveten në një ambient të

komunikime dhe zgjidhje të rëndësishme në ambientin e punës dhe për këtë arsye shumë herë ekzagjeroni.



GAFORRJA

Doni të jeni ju të parët në

komunikime dhe zgjidhje të rëndësishme në ambientin e punës dhe për këtë arsye shumë herë ekzagjeroni.



LUANI

Ka gjithmonë të papritura në rrugën

që përshkoni. Mos jini të sigurt për gjëra që nuk janë në dorën tuaj. Jepuni zgjidhje disa problemeve që do t'ju dalin.



VI RGJËR ESHA

Do t'ju duhet të shpjego-

heni për disa situata që tek të tjerët kanë lënë shije të keqe sidomos tek ata që ju kanë më për zemër.



PESHORJA

Do të hasni në disa pengesa që

do t'ju prishin humorin sot. Mund t'u flisni me një ton të ashpër personave që nuk e meritojnë.



AKREPI

Ajo që po ndodh rreth jush vjen si pasojë e

veprimeve të njëpasnjëshme që keni marrë. Nëse nuk do t'ju pëlqejë duhet të shikoni opsione të reja.



SHIGJETARI

Nuk po arrini ta kuptoni sjelljen e disa

personave karshi jush. Kjo ju ka futur në një pasiguri që po ju shqetëson disi sot.



BRICJAPI

Duhet t'i jepni më shumë kohë në

dispozicion partnerit të shpjegojë një situatë që është keqkuptuar nga të dyja palët.



UJORI

Sot keni nevojë të çlirohni nga stresi i

ditës dhe po kërkonte alternativa të reja për t'u kënaqur. Do të jeni në kërkim të një flirti të momentit.



PESHQIT

Nuk ka asgjë të keqe të

kërkoni më tepër nga një marrëveshje apo edhe nga një flirt i ri. Por, mos ngatëroni kërkesën me pretendimin.

Shakira akuzohet për evazion fiskal nga autoritetet spanjolle



Vitet e fundit qeveria spanjolle është akuzuar se i ka ngarkuar me evazion fiskal yjet e futbollit si Lionel Messi, Cristiano Ronaldo dhe Javier Mascherano. Por këtë javë autoritetet spanjolle kanë kthyer fokusin e tyre te këngëtarët e

pasura. Është Shakira, gruaja e futbollistit të Barcelonës, Gerard Piqué, e cila po akuzohet për evazion fiskal për vitet 2012, 2013 dhe 2014. Ajo, edhe pse e lindur në Kolumbi, pas martesës me Piquen u bë shtetase edhe e Spanjës.

Travis Scott i blen së dashurës veturë në vlerë të 400 mijë dollarëve



Reperi Travis Scott i ka blerë një veturë si dhuratë të dashurës së tij Kylie Jenner. Kjo veturë është e modelit Rolls-Royce Wraith dhe kap vlerën e 400

mijë dollarëve amerikanë. Në të është i shkruar emri Kylie Jenner. Lajmin e ka bërë me dije vetë biznesmenja Kylie Jenner me anë të një postimi në "Instagram".



Heidi Klum puthet me të dashurin në publik

Kohët e fundit Heidi Klum e ka treguar vazhdimisht në publik lidhjen e saj me Tom Kaulitz. Madje ditën e shtunë ata janë fotografuar edhe duke u puthur derisa po blinin për festën e

Krishtlindjeve, në Beverly Hills, bashkë me të bijën e modelueses, Lou. Modeluesja 45-vjeçare shoqërohej nga e bija nëntëvjeçare, nga martesja e saj e mëhershme, derisa po bënte blerje në një shitore bizhuterish.

Nicki Minaj e bllokon Meek Millin në rrjetet sociale

Meek Mill nuk ka gjykime për ish të dashurën e tij, Nicki Minaj. Reperi i "Dangerous" ka komunikuar me fansat ditën e diel në "Instagram", ku i është përgjigjur një serie të pyetjeve. Një nga pyetjet e atyre që e ndjekin dhe e adhurojnë reperin ishte se si ndihet ai për të dashurin e ish të dashurës së tij (Nicki Minaj), Kenneth Petty. "Nuk ndjej asgjë. Nuk e njoh atë në mënyrë që të kemi një gjykim për të", ka shkruar Mill në "Twitter"



duke iu referuar historisë kontroverze me ligjet. "Unë kam dashur ta njoh, të marrë më shumë detaje në faqen e saj, por e kuptova se Nicki më ka bllokuar", ka thënë Milli.



| Autor: GAZMEND MORINA | | FORMË SHITETI I PËRBËRË NGA BASHKIMI I DISA SHITET-EVE ME TË VOGLA (shq.) | KALIBËR I TYTËS SË ARMËS (shq.) | MINDERI I ULËT (vjet.) | QË NXË NJË OKË (PËR ENËT) | GAZ NATYROR I THJESHTE, PA NGJYRË E PA ERË | ELIZABETH TAYLOR | ZULMË | ZANORE | ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR BORIÇI | EPOKA E RE | RRIP I LLAMBËS |
|------------------------------|---|---|---|--|--|---|--|------------------------------------|---|---|--|----------------------------|
| | I JASHTËZAKONSHËM, I VEÇANTË | | | | | | | | | | BASHKËT. DETAR | |
| | PUSULLA | | | | | | | | | NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE METODË STUDIMI | | |
| | GRUA QË VALLËZON ME NJË KAVALIER (sh.shq.) | | | | | | TENISTI SAFIN TËRËSOR | | | | | |
| | PJESA MË E LARTË E MË E PRIVILEGJUAR E KLASAVE (sh.shq.) | | | | | | | | SHPEND UJI SHTEGTAR (shq.) KËNGËTARJA REXHEPI | | | |
| | "RODA" QË KA TË BËJË ME ZËRIN | | | | ELEKTRODA E POLIT POZITIV NË NJË BURIM RRYME KRAHINË NË KOSOVË | | | | | INTER, LECCE ISMET LUZHA | | |
| | → | | | | | | | | KRYEQYTETI I ESTONISË (pashq.) BASHKËT. | | | PJESË E KËMISHËS (sh.shq.) |
| | LLOJ, SOJ | | | | | BASKETBOLLISTI BESIM DJALË OSE VAJZË DERI TETË A NËNTË VJEÇ | | | | | | |
| EPOKA E RE | AKTORI AMERIKAN NË FOTO XHEK | PJESËTARËT E NJË FISI ILIR | TAKOJ DIKË A DIÇKA RASTËSISHT E PAPERITUR, NDESH | SHTET NË AZI (pashq.) | DJALË QË KA MBETUR PA PRINDËR | ZANORE EMA TOMPSON | OLIVER KAHN VEZAK | | | AKTORJA ANGLEZE HURLEY REGJISORI HOLLIVUDIAN ... BURTON | RAMADAN AVDIU TAKOHET | |
| | KRAHINË, ANË (vjet.) | ○ | | | | | THURJE, QËNDISJE (sh.shq.) | | | | | BASHKËT. KILOGRAM (krah.) |
| | KUZHINË PRANË XHAMISË | ○ | | | | | AKTORJA MUQOLLI PREMTIMI SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK | | | | "K" në mes të dy "A" I PARI I MURGJVE NË NJË ABACI | |
| | ARKË E VOGËL PREJ DRURI KU RUHEN SENDE ME VLERË (sh.shq.) | ○ | | | | BRAGA, ACADEMICA ZAKON I KEQ | MA JEP PËRSËRITËS (gram.) | | | BABAIT INSTITUCION I LARTË SHKENCOR | | |
| | OLIVER NEUVILLE ZË I ULËT E I THELLË I GRAVE NË TË KËNDUAR | ○ | RRAFSHIM, BARAZIM LARTËSISH DEGË E GJUHËSISË | | | | | | KORIJE PIJE ALKOOLIKE, QË NXIRRET NGA MUSHTI I RRUSHIT | | | MARRE |
| | → | ○ | | AKTORI AMERIKAN ... DAMON (shqip.) AVULL QË DEL NGA TOKA | | | SEKT I VEÇANTË I MYSLIMANËVE (sh.shq.) SELEN | | | | | |
| | ISH NGASËSI I "FORMULA 1" AIRTON | ○ | | | FUTBOLLISTI FRANCEZ XHIBRIL (QPR) TOKA E BUKËS | | | | KOHË DERI KUR DUHET TË KRYHET NJË PUNË (sh.pashq.) ALUMIN | | | ZANORE MONOPOLIZIM |
| | KRYEQYTETI KANADEZ | ○ | | | | KURESHTJE QYTET I MADH NË GJERMANI | | | | FLETORË PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE HIJSHI, HIR | | |
| | BASHKËT. | ○ | VDEKJA VJERSHË MË VARGJE TË SHKËPUTURA NGA VEPRA TJERA (lit.) | | | | PARAGRAF PARIM I QARTË E I PËRCAKTUAR MIRË | | | ZANORE | DY BASHKËTINGËLLORE NË KËTË MOMENT | |
| EPOKA E RE | VENDIM QË MERRET PËR NJË ÇËSHITJE, RRUËGËZGJIDHJE (vjet.) KËNGËTARI ARIF | | | | | KASTRIOT TUSHA YNDYRË PËR FYTYRË (shq.) | | STADIUMI I KLUBIT MILAN "... SIRO" | U PESHOVA PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE | | | PRIJËS I HUNËVE |
| | HUQ, MANI (sh.pashq.) | | | | I ÇMENDURI PJESË E MUAJIT | | | | | | VËLLAI I MADH RUGBY LEAGUE IRELAND | |
| | LITËR, NITON | | | | DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR | | | | | LECKAT PËR ARNIM BASHKË, ME | | |
| | KALI I STËRVITUR | | | IRNOSET (bised.) ERMELINDA MEKSI | | | | SPORT UJI "SOMALIA" | | MUNGESË E SHTYPJES, E VARËSISË DHE E KUFIZIMEVE NEON | | |
| | ZAKONET, TRADITAT | | | | | QENDËR E DIÇKAJE | | | KËNGËTARË E NJOHUR NË SHQIPËRI SHKRONJA XIX | | ISLANDA, LETONIA ZANORE | |
| | I MALLKOVA | | | | | QESËNDISËSË | | | | | KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON | |

Palestër, restorant, piceri, të gjitha sekretet e Cristiano Ronaldos

Cristiano Ronaldo dhe Torino, një "marrëdhënie e lindur menjëherë. Që nga zbarkimi i tij, qyteti është çmendur për fenomenin e ri, i cili jo vetëm në fushë, por edhe jashtë saj ndidhet tashmë si në shtëpinë e tij.

Çfarë bën CR7 në Torino në kohën e lirë? Palestër, restorant, piceri, shëtitje. Lexoni të gjitha sekretet e kampionit 34-vjeçar torinez.

sekretet e CR7 është edhe gjumi, që duhet të jetë të paktën 7-8 orë në mbrëmje.

Restorante

Sapo mundet, Cristiano po shijon edhe Torinon, me masë dhe pa asnjë teprim. Ndonjë shëtitje në sheshin "Vittorio Veneto" dhe në zonën e qendrës së qytetit, ndonjë dalje për darkë, me familjen dhe me miqtë më të ngushtë. Për mbrëmjen e parë "mondane", në verë, me partneren e tij Georgina ka zgjedhur,

Në shtëpi

Ronaldo dhe Torino, një marrëdhënie e lindur menjëherë. Që nga zbarkimi i tij, qyteti është çmendur për fenomenin, i ndihet si në shtëpi. Për jetën e tij torineze, CR7 ka zgjedhur një vilë ekskluzive mbi një kodër, pas kishës Gran Madre, ku shi-



CR7, i cili për momentin ka parapëlqyer të mungojë në përkushtimet e Portugalisë, është kthyer në Madrid e Lisbonë, por ka shijuar edhe Liqenin e Komos. Së fundmi, në pushimin e fundit të kombëtareve, ka festuar ditëlindjen e parë të vajzës Alana Martina me një pushim të shkurtër në Londër.

Me makinë në Londër

Të gjithë e dinë që Ronaldo ka një pasion të madh për makinat. Garazhi i tij është i pasur me makina jashtë serie sportive dhe luksoze, nga Ferrari te Lamborghini. Një pjesë e makinave të tij ka mbërritur edhe në Torino, por Cristiano i përdor

me radhë. Në javët e tij të para juventine, një shofer e ka shoqëruar në stërvitje, shpesh i ndjekur edhe nga një eskortë. Pastaj, pak nga pak i mësoi rrugët e Torinos dhe tani lëviz në autonomi, shpesh me Jeep-in e klubit ose me Suv-in që ka në pronësi.

(gazeta-shqip.com)



jon një panoranë mbresëlënëse mbi Mole Antonelliana dhe mbi bukuritë e qytetit.

"La Credenza" në San Maurizio Canavese, restoranti i drejtuar nga Giovanni Grassi diku jashtë qytetit.

Palestra


Në vilën e tij superluksoze ka gjithçka: para së gjithash një palestër dhe një pishinë të mbuluar për t'u kujdesur për formën edhe jashtë qendrës sportive të Continassa-s dhe nga oraret normale të stërvitjeve. Pësia, aktiviteti kardiak dhe mjete të tjera sportive për kohën e tij të lirë. Mbi tarracë është ndërtuar një vend i përshtatshëm për të bërë solar. Aktivitet fizik, por edhe pushim, sepse një nga

Piceria

Por "alieni", i ka lejuar vetes edhe një etapë në "Sesto Gusto" për të shijuar një picë nga shefi Massimiliano Prete. Sikur të mos ndodhte asgjë, në mes të klientëve të tjerë, pa asnjë privilegj. Një thjeshtësi e vërtetë për të madhin Ronaldo.

Liqeni i Komos

Në pushimet e kampionatit,



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MIDDLESBROUGH - BURTON ALBION

1

ABERDEEN - DUNDEE

1

MONCHENGLADBACH - NURNBERG

1

Arrihet marrëveshja për menaxhimin e stadiumit 'Fadil Vokrri'

Stadiumi "Fadil Vokrri", që ishte shumë me fat për Përfaqësuesen e Kosovës në Ligën e Kombeve ku "Dardanët" arritën sukses historik, duke u kualifikuar deri në gjysmëfinale, do të menaxhohet nga Federata e Futbollit në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, të paktën në ciklin eliminator për Kampionatin Evropian "Euro 2020". Marrëveshjen e arritur në mes të FFK-së dhe Komunës së Prishtinës e ka miratuar edhe ministri i Sportit, Kujtim Gashi

"Epoka e re"

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës dhe Komuna e Prishtinës kanë arritur të hënë marrëveshje për menaxhimin e stadiumit "Fadil Vokrri". Kjo marrëveshje është arritur pas takimit të kryetarit të Federatës së Futbollit, Agim Ademi, me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti. FFK-ja në bashkëpunim me Komunën do ta menaxhojë stadiumin që e bartë emrin e legjendës Fadil Vokrri në ciklin kualifikues "Euro 2020". "Është arritur marrëveshja për menaxhimin e stadiumit 'Fadil Vokrri', veçmas gjatë ciklit kualifikues për 'Euro 2020' të menaxhohet nga FFK-ja në bashkëpunim me komunën. Këtë marrëveshje e ka miratuar edhe ministri i Sportit, Kujtim Gashi, i cili është takuar më pas me presidentin Ademi dhe kryetarin Ahmeti", thuhet në njoftimin e FFK-së. Drejtuesit e Federatës së Futbollit



dhe ata të Komunës së Prishtinës kanë diskutuar edhe për ndërtimin e dy fushave me bari sintetik në kryeqytet, të cilat do ta ndihmonin shumë zhvillimin e futbollit. Kryetari Ademi ka kërkuar që komuna urgjentisht ta gjejë tokën ku do të ndërtohen këto dy fusha dhe në momentin që ajo i kryen procedurat e dhënies së tokës në shfrytëzim, atëherë FFK-ja menjëherë do të jetë

e gatshme ta fillojë punën për realizimin e tyre. Po ashtu, u diskutua edhe dhënia e lejes për realizimin e projektit të ri të selisë së Federatës së Futbollit ku, sipas të gjitha gjasave, pas paraqitjes së projektit, do të jepet drita e gjelbër dhe do të fillohet puna për jetësimin e këtij projekti që, pa dyshim, është tejet i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të FFK-së.

Liverpool - Bayern, finalja e parakohshme në Ligën e Kampionëve

NYON, 17 DHJETOR - Në Nyon të Zvicrës, u hodh shorti për raundin e dytë të Ligës së Kampionëve ose, siç njihet ndryshe, raundi me eliminim direkt. Pas fazës së grupeve, tashmë janë 16 skuadra që do të vijojnë betejën për më të mirin e Evropës. Lufta bëhet për kurorën që e mban në tri sezonet e fundit radhazi Real Madridi. Natyrisht, edhe "Los Blancos" do të tentojë të mos zbrësë nga fronti. Goglat e shortit kanë përvijuar këto

Çiftet e 1/8 së finales:

Atletico Madrid - Juventus
Schalke 04 - Manchester City
Manchester United - PSG
Tottenham - Borussia Dortmund
Olympique Lyon - Barcelona
Roma - Porto
Ajax - Real Madrid
Liverpool - Bayern Munchen



përplasje, ku spikat Liverpool - Bayern Munchen, e cila fare mirë mund të konsiderohet një finale e parakohshme e kësaj gare. Ndashjet e

para të këtij raundi do të luhen në katër ditë: më 12, 13, 19 dhe 20 shkurt, ndërsa ato të kthimit më 5, 6, 12 dhe 13 mars.

SHKURT

Munishi: Feronikeli, klubi i vetëm që nuk më ka mbetur borxh

Trajneri Ismet Munishi ka thënë se skuadra e Feronikelit e ka paguar edhe tre muaj të tjerë pasi është larguar pasi e ka ndërprerë bashkëpunimin. "Feronikeli është klubi i vetëm që pasi e kam ndërprerë bashkëpunimin jam paguar për tre muaj radhazi. Feronikeli është klubi më korrekt ku kam punuar deri më tani. Feronikelit i dëshiroj shumë suksese dhe drejtuesve të klubit të cilët janë shumë korrektë. Ata janë fitimtarë edhe nëse nuk dalin kampionë, pasi duhet të jesh shumë korrekt në futboll për të pasur sukses", ka thënë Munishi në emisionin "Arena" në "Tribuna Channel". Mushi ka treguar se, përveç Feronikelit, të gjitha klubet e tjera i kanë mbetur borxh.

Van Dijki: Shaqiri mund ta vendosë titullin në Premierë Ligë

Virgil van Dijk beson se paraqitjet e Xherdan Shaqirit mund të jenë vendimtare në garën për titull të kampionit në Premierë Ligë. Futbollisti shqiptar u inkuadrua në lojë në derbin ndaj Manchester Unitedit në njëzetë minutat e fundit, kurse shënoi dy gola për fitoren (3-1). "Në fund, Shaqa i madh erdhi dhe bëri punën për ne. Ai është një lojtar fantastik. Ai e tregoi atë që nga ndeshja e parë kundër Manchester Unitedit në Amerikë. Ai është diçka ndryshe. Ishte e veçantë. Kishte shumë kohë më parë që ne nuk fitonim dot ndaj tyre në shtëpi", ka deklaruar Van Dijki.

Hasani priti zyrtarin e lartë të ETBF-së, Marios Nicolaides

Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani, ka pritur në zyrën e vet anëtarin e Federatës Evropiane të Boulingut (ETBF), Marios Nicolaides, njëherësh kryetar i Federatës Mesdhetare të Boulingut, si dhe delegat teknik i ETBF-s. Nicolaides shoqërohej nga kryetari i Federatës së Boulingut të Kosovës (FBOUK), Fitim Fazliu dhe sekretari i përgjithshëm, Mirsad Sejdiu, me ftesë të të cilëve qëndroi në Kosovë për të mbajtur trajnim me gjyqtarët e boulingut. Presidenti Hasani e falënderoi Nicolaidesin për trajnimin e mbajtur me gjyqtarët si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që ETBF po i jep FBOUK-s në zhvillimin e saj. Të dyja palët bashkëbiseduan për bashkëpunimin që Komiteti Olimpik i Kosovës ka me Federatën e Boulingut të Kosovës. Nicolaides i premtoi KOK-ut dhe FBOUK-s që, nëse përmirësohet infrastruktura në Kosovë, mund t'i japë federatës sonë organizimin e Kampionatit Mesdhetar të Boulingut për vitin 2021, për çka mori mbështetjen e plotë të presidentit Hasani. FBOUK-ja është anëtare me të drejta të plota e ETBF-s që nga viti 2015, kurse në fund të muajit të kaluar u pranua edhe në Federatën Mesdhetare të Boulingut.

"Daily Mail": Schumacheri ka bërë përparime të jashtëzakonshme

CYRIH, 17 DHJETOR - Në mediet evropiane po qarkullon një lajm i madh mbi gjendjen shëndetësore të Michael Schumacherit. Sipas "Daily Mail", ish-kampioni i Botës në Formula 1 ka

bërë përparime të jashtëzakonshme sa i përket shëndetit, pas një periudhe të gjatë rehabilituese si pasojë e aksidentit të pësuar në Meribel të Francës. Thuhet si ish-feraristi është i vetëdijshëm

dhe nuk ka më nevojë për ndihmën e pajisjeve. Michael Schumacher nuk është i lidhur pas shtrimit dhe nuk ka nevojë për frymëmarrje artificiale për të qëndruar në jetë. Po sipas "Daily Mail", shtatë

herë kampioni i botës në Formula 1 ka peshë normale. Schumacher banon në shtëpinë e vet në Zvicër, në një dhomë të përshtatur për trajtimin shëndetësor. Informacionet përkasin me deklaratën e pak ditëve më

parë të presidentit të FIA-s, Jean Todt, që theksoi se e kishte ndjekur bashkë me Shumacherin garën për Çmimin e Madh të Brazilit, por pa dhënë detaje të tjera mbi shëndetin e gjermanit.



Short i lehtë për favoritët në Evropa Ligë



NION, 17 DHJETOR - Në Nion të Zvicrës është hedhur edhe shorti i Evropa Ligës, teksa edhe në këtë kompeticion ka mjaft skuadra të mëdha dhe me emër. Rregullat janë të njëjta si për Ligën e Kampioneve, por ekipet e Rusisë dhe Ukrainës nuk mund të luajnë me njëra-tjetrën. Kompeticioni i dytë për

nga rëndësia dhe vlera ka dhuruar duela të bukura dhe interesante. Kundërshtar austriak për Interin që do të ndeshet me Rapidin e Vjenës. Probleme nuk mendohet të ketë as Arsenali, që do të ndeshet me Bate Borisovin. Short i lehtë edhe për Napolin, që do të përballet me zvicër-

ÇIFTET NË EVROPA LIGË

Viktoria Plzen - Dinamo Zagreb
Club Brugge - Salzburg
Rapid Viena - Inter
Slavia Pragë - Genk
Leverkusen - Krasnodar
Zurich - Napoli
Malmo - Chelsea
Shaktar D. - E. Frankfurt
Celtic - Valencia
Rennes - Real Betis
Olimpiacos - Dinamo Kiev
Lazio - Sevilla
Fenerbahçe - Zenit
Bate Borisov - Arsenal
Sporting Lisbona - Villareal
Galatasaray - Benfica

anët e Zurichit, ndërsa Lazio - Sevilla është përballja më e fortë e këtij turi. Transfertë suedeze për Chelsen e Sarrit që do të luajë me Malmon.

Denveri mposhti Toronton



DENEVER, 17 DHJETOR - Spikat humbja e Toronto Raptorsit në Konferencën e Lindjes. Skuadra kanadeze u mund 95-86 nga Denver Nuggetsit, ndeshje ku loja e të dyja skuadrave ishte me luhate. Jokiçi me 26 pikë bëri diferencën në fushë për Denverin, ndërsa 29 pikët e 14 reboundet e Leonardos për Toronton mbetën për statistika. Deri diku kjo është një humbje e pranueshme për Raptorsin pasi

përballë kishte skuadrën që kryeson konferencën e Perëndimit, edhe pse në mënyrë surprizë. Humbet edhe skuadra e Los Angeles Lakersit, që u mposht 128-110 nga Washington Wizardsi brenda në kryeqytet, takim që u dominua nga basketbollistët vendës të cilët e merituan fitoren. John Wall me 40 pikë e 14 asistime ishte lideri mbi parket për Washingtonin, ndërsa në krahun tjetër LeBron Jamesi

zhgënjeu totalisht, pasi e mbylli me 13 pikë, duke mos qenë në një mbrëmje të mirë.

REZULTATET

| | |
|--------------------------|---------|
| Brooklyn - Atlanta | 144-127 |
| Cleveland - Philadelphia | 105-128 |
| Indiana - New York | 110-99 |
| Washington - Lakers | 128-110 |
| Dallas - Sacramento | 113-120 |
| New Orleans - Miami | 96-102 |
| Denver - Toronto | 95-86 |

SHKURT

De Ligt fiton çmimin "Golden Boy 2018"

Talenti i Ajaxit, Matthijs de Ligt, është futbollisti më i mirë i ri i vitit. Qendërmbrojtësi i ekipit holandez është shpallur lojtari më premtues në Evropë nën moshën 21 vjeç. 19-vjeçari gjatë këtij viti ka qenë një prej lojtarëve më të mirë edhe në formacionin e kombëtares holandeze. Vitin e kaluar këtë çmim e fitoi Kylian Mbappe, ndërsa në të shkuarën "Golden Boy" e ka bërë të tijin edhe Lionel Messi. De Ligt në këtë garë e mposhti bashkëkombësin e tij, Justin Kluviert e Romës, Trent Alexander-Arnold e Liverpoolit, Patrick Cutrone e Milanit dhe Vinicius Juniorin e Real Madridit.

Kloppi: Mezi e pret përballjen me Bayernin

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se mezi po pret përballjen me Bayern Munchenin në fazën e parë të eliminimit direkt të Ligës së Kampioneve. "Të gjithë e njohim stadiumin, atmosfera është e madhe. Është me të vërtetë udhëtim i mirë për të gjithë tifozët, është një qytet fantastik, pra çdo gjë është mirë. Udhëtimi nuk është shumë i gjatë dhe natyrisht ne dimë më shumë për futbollin gjerman sesa ligën tonë", ka thënë Klopp. "Në fund, lojtarët vendosin në fushë. Ta provojmë. Jo shumë kohë më parë kam luajtur në Bayern në ndeshje zyrtare, pra mezi po pres", ka shtuar Klopp.

Kovaqi: Liverpooli favorit, por Bayerni mund të kualifikohet

Trajneri i Bayern Munchenit, Niko Kovaq, ka thënë se Liverpooli është favorit në letër, por se Bayerni mund të kualifikohet në çerekfinale. "Ne jemi të lumtur me shortin. Ata ishin skuadra më e vështirë që mund të përballeshim. Liverpooli ishte finalist sezonin e kaluar dhe aktualisht është në krye të Ligës Premierë. Ai është favorit kryesor për ta fituar Ligën e Kampioneve këtë vit, por ne jemi Bayerni dhe ai e di se duhet të vijë te ne për ndeshjen e kthimit. Mundësitë për kualifikim janë të barabarta", ka thënë Kovaq.

Pepe fiton zemrën e të gjithëve pas largimit nga Beshiktashi

Mbrojtësi portugez, Pepe, i ka dhënë fund aventurës në kampionatin turk, teksa ka arritur marrëveshjen për ndërprerjen e kontratës. Nga ky moment 35-vjeçari do të jetë i lirë, teksa mediet turke raportojnë se divorci ka ardhur për shkaqe ekonomike, pasi klubi nuk ishte në gjendje ta paguante pagën e lartë. Por, ajo që ka rënë në sy ka qenë ajo çfarë luzitani ka bërë për punonjësit e klubit. Ai ka bërë një gjest të klasës së lartë duke paguar pagën e shumë punonjësve të klubit si kuzhinierët, kujdestarët e stadiumit dhe punonjësve të tjerë. Kjo ka qenë një nga shembujt më të mirë që Pepe ka dhënë në karrierën e tij dhe ka lënë një shije mjaft të mirë në sytë e tifozëve të futbollit.

Simeone: Një ditë do të jem trajner i Interit

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Pablo Simeone, shpesh e ka përsëritur faktin se është shumë i lidhur me Interin dhe se një ditë dëshiron që të ulet në stolin e zikaltërve. "Sigurisht se një ditë do të ndodhë. Mungon një datë fikse sigurisht sepse unë kam ende edhe një vit kontratë me Atletico. Gjithsesi këtë që po them në këto çaste e kam shprehur gjithmonë, ndaj nuk e shoh të arsyeshme të shtoj edhe diçka tjetër", ka thënë Simeone.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT // OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Vazhdim i Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

| | |
|--------------------------|---|
| Titulli i punës: | Shërbime Auditimi |
| Paga mujore: | Sipas marrëveshjes |
| Raportin te: | SIDA/ABGJ |
| Lloji i kontratës: | Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV) |
| Kohëzgjatja e kontratës: | Sipas marrëveshjes |

Termet Standarde të Referencës¹, për Auditimin Vjetor në mbështetje të Programit/Projektit.

Agjencia për Barazi Gjinore dëshiron të angazhojë shërbimet e një Firme Audituese me qëllim të auditimit të "Mbështetjes për Agjencinë për Barazi Gjinore në Kosovë, 2015- 2019 ", siç përcaktohet në Marrëveshjen ndërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Sida-s.

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të auditimit të lëshuara nga IAASB², nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar (Kontabilist Publik i Miratuar / Kontabilist Publik i Autorizuar ose ekuivalent).

Objekti: Auditimi i Raportit Financiar për periudhën (01.01.2018 deri 31.12.2018) i cili dorëzohet në Sida , për një Opinion të Auditimit sipas ISA 800/805 mbi atë nëse Raporti Financiar për Mbështetje të Agjencisë për Barazi Gjinore në Kosovë, 2015-2019", është në

¹ Termet e Referencës për angazhimin e auditorit të pavarur, janë hartuar dhe bazuar në detyrimet kontraktuale të specifikuar në Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar mes Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës dhe Qeverisë Suedeze, përfaqësuar nga SIDA, më 11/06/2015; Neni 7 dhe shtojca IV e Marrëveshjes.

² Bordi Ndërkombëtar për Standardet e Auditimit dhe Sigurisë (IAASB).

përputhje me Udhëzimin e Sida-s për raportimin financiar sipas Marrëveshjes ndërmjet Sida-s dhe Agjencisë për Barazi Gjinore; Anexi II në marrëveshjen mes ABGJ-së dhe SIDA's.

Detyra (caktim) shtesë; në bazë të Procedurave 4400 të dakorduara në Kushtet e veçanta të referencës që do të miratohen nga Sida;

- Përcjellja, nëse kostot e pagave të debituar për Projektin janë të regjistruara përgjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit, në mënyrë të sistematizuar dhe shqyrtimi nëse kostot e pagave mund të vërtetohen me dokumente të mjaftueshme mbështetëse³.
- Shqyrtimi, nëse raporti financiar përfshin një krahasim për çdo zë të buxhetit, ndërmjet kostove faktike / shpenzimeve të aktiviteteve dhe kostove / shpenzimeve të projektuara si të miratuara nga Sida për periudhë.
- Në bazë të materialitetit dhe rrezikut, auditori do të shqyrtojë nëse ekziston dokumentacioni mbështetës lidhur me shpenzimet e bëra.
- Përcjellja nëse Agjencia për Barazi Gjinore ka zbatuar rekomandimet sipas planit kohor në rishikimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit, KPMG, mars 2015: Ekzaminimi përfshinë shqyrtimin nëse Agjencia për Barazi Gjinore ka filluar zbatimin e pikave të renditura të veprimit siç përshkruhet në Planin e Veprimit të Agjencisë për Barazi Gjinore, 21 Prill 2015.
- Shqyrtimi nëse fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj valutor janë të reflektuar në përputhje me atë që është përcaktuar në marrëveshje, duke përfshirë shtojcat.
- Nëse Agjencia për Barazi Gjinore i është përmbajtur Rregullave dhe Rregulloreve të ndërlydhura me tatimet (e.g. PAYE⁴) dhe Tarifatat e Sigurimeve Shoqërore.
- Përcjellja nëse Agjencia për Barazi Gjinore ka respektuar udhëzimet e prokurimit të përcaktuara në marrëveshje.
- Shqyrtimi nëse bilanci dalës për periudhën paraprake është i njëjtë si bilanci hyrës për periudhën aktuale.
- Detyra shtesë në përputhje me procedurat e rena dakord dhe termet e referencës.

Raportimi

Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia e përdorur do të paraqiten në raportin e auditimit. Raportimi duhet të nënshkruhet nga auditori përgjegjës (jo vetëm nga firma e auditimit) dhe titulli.

Raportimi nga auditori do të përfshijë raportin e një auditori të pavarur në përputhje me formatin në standardin ISA 800/805 dhe opinionin i auditorit duhet të shprehet qartë, si dhe letra e Menaxhmentit me gjetjet dhe dobësitë e identifikuar gjatë procesit të auditimit. Auditori pa

³ Nëse buxheti përfshin kostot e pagave që do të debitohen për projektin, auditori gjithmonë do të shqyrtojë kostot e pagave të përcaktuara këtu.

⁴ tatimi progresiv mbi të ardhurat/ tatimi i mbajtur në burim.

marrë parasysh materialitetin do të kuantifikojë shumën për kostot në mungesë të dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës.

Auditori duhet të bëjë rekomandime për të adresuar çdo dobësi të identifikuar dhe rekomandimet duhet të paraqiten sipas renditjes prioritare. Nëse auditori vlerëson se nuk janë identifikuar gjetje apo mangësi gjatë auditimit që do të rezultojnë në një letër të Menaxhmentit, një shpjegim i këtij vlerësimi duhet të shpallset në raportimin e auditimit.

Masat e marra nga Agjencia për Barazi Gjinore për të adresuar dobësitë e identifikuar në auditimet e mëparshme gjithashtu do të paraqiten në letrën e menaxhmentit.

Përzgjedhja e Auditorit do të miratohet nga Sida

Detyra shtesë në përputhje me procedurat e rena dakord sipas paragrafit III do të raportohen në një pjesë të veçantë në përputhje me termet e referencës.

Auditori duhet të dorëzojë:

Një profil të vetin me të cilin dëshmohet aftësia profesionale dhe eksperiencat e mëparshme dhe dëshmia e realizimit të së paku dy auditimeve të fundit të cilat i ka realizuar;

- Një letër, ku shpreh interesin për të realizuar një projekt të tillë;
- Një Projekt-Propozim të shkurtër i cili duhet të përfshijë:

- 1) Planin dhe kalendarin e detajuar të aktiviteteve të projektit;
- 2) Metodologjinë e punës;
- 3) Dokumentacionin e nevojshëm si dëshmi për burimet e tjera financiare dhe materiale.

Konkursi vazhdohet edhe për 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data 18.12.2018 deri me datë 24.12.2018, nga dita e publikimit në web faqen e ABGJ-së : <http://abgj.rks-gov.net/>.

Paraqitja e kërkesave për aplikim do të bëhet në Divizionin për Administratë, Buxhet dhe Financa në adresën: Ndërtesa e Qeverisë, Kati 7 Nr.Zyrës 711 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/200 14 274.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Produzivanje javnog konkursa za ugovor o posebnim uslugama

| | |
|-------------------------|------------------------------------|
| Naziv pozicije: | Revizorske usluge |
| Mesečna zarada: | Prema dogovoru |
| Izveštava kod: | SIDA/ARP |
| Vrsta ugovora: | Ugovor o posebnim uslugama – (UPU) |
| Vreme trajanja ugovora: | Prema dogovoru |

Standardni projektni zadatak⁵, za godišnju reviziju u podršci Programa/Projekta.

Agencija za rodnu ravnopravnost čeli da angažuje usluge jedne revizorske kompanije u cilju revizije programa „Podrška Agenciji za ravnopravnost polova na Kosovu 2015-2019“, kako se utvrđuje u Sporazumu između Agencije za ravnopravnost polova i SIDA.

Revizija će se vršiti u skladu sa međunarodnim standardima revizije izdatih od IAASB⁶, od jednog spoljnog revizora, nezavisnog i kvalifikovanog (Sertifikovan javni računovoda / Ovlašćen javni računovoda ili ekvivalentan).

Cilj: Revizija finansijskog izveštaja za period (01.01.2018 do 31.12.2018) koji se podnosi u SIDA, za mišljenje revizije prema standardu ISA 800/805 oko toga da li je Finansijski izveštaj „Podrške agenciji za ravnopravnost polova na Kosovu 2015-2019“, u skladu sa uputstvima SIDA o finansijskom izveštavanju prema Sporazumu između SIDA i Agencije za ravnopravnost polova; Aneks II u sporazumu između ARP-a i SIDA.

⁵ Projektni zadatak za angažovanje nezavisnog revizora je utvrđen i zasniva se na specifične ugovome obaveze u Sporazumu o razumevanju potpisan od Agencije za ravnopravnost polova Kosova i Vlade Švedske, zastupljena od SIDA, dana 11/06/2015; Član 7. i Aneks IV Sporazuma.

⁶ Međunarodni Odbor za standarde revizije i bezbednosti (IAASB).

Dodatne dužnosti (zadaci); na osnovu dogovorenih Postupaka 4400 u Posebnim uslovima reference koji će se usvojiti od SIDA;

- Praćenje, da li su troškovi debitovanih zarada za Projekat evidentirani tokom cele godine, na sistematski način, i razmatranje da li se troškovi zarada mogu potvrditi sa dovoljno pratećim dokumentima⁷.
- Razmatranje, da li finansijski izveštaj obuhvata poređenje za svaku stavku budžeta, putem stvarnih troškova / rashoda aktivnosti i predviđenih troškova / rashoda usvojenih od SIDA za period.
- Na osnovu materijalnosti i rizika, revizor će razmatrati da li postoji prateća dokumentacija u vezi sa urađenim troškovima.
- Praćenje da li je Agencija za ravnopravnosti polova sprovodila preporuke prema dinamici u pregledu interne kontrole i upravljanja, KPMG, mart 2015. Ispitivanje obuhvata da li je Agencija za ravnopravnost polova počela sa sprovođenjem navedenih akcionih tačaka kako se propisuje u Akcionom planu Agencije za ravnopravnost polova, 21. april 2015.
- Razmatranje da li se dobici i gubici od razmene strane valute odražavaju u skladu sa time šta je utvrđeno u sporazumu, uključujući i anekse.
- Da li se Agencija za ravnopravnost polova pridržavala pravilnicima i uredbama koje se odnose na poreze (npr. PAYE⁸) i tarifama društvenih osiguranja.
- Praćenje da li je Agencija za ravnopravnost polova poštovala uputstva javne nabavke, koja su utvrđena u sporazumu.
- Razmatranje da li je bilans uspeha za prethodni period isti kao bilans stanja za trenutni period.
- Dodatne dužnosti u skladu sa dogovorenim postupcima i projektnim zadatkom.

Izveštavanje

Delokrug revizije i korišćena metodologija predstavljaju se u izveštaju o reviziji.

Izveštavanje treba da se potpisuje od odgovornog revizora (ne samo od kompanije revizije) i naslova.

Izveštavanje od revizora obuhvatiće izveštaj nezavisnog revizora u skladu sa formatom u standardu ISA 800/805 i mišljenje revizora treba jasno da se navede, kao i pismo rukovodstva sa identifikovanim nalazima i manama tokom procesa revizije. Bez obzira na materijalnost revizora će da kvantifikuje iznos o troškovima u nedostatku dovoljno prateće dokumentacije.

Revizor treba da daje preporuke za rešavanje svake identifikovane slabosti a preporuke treba da se predstavljaju po redosledu prioriteta. Ako revizor procenjuje da su identifikovani nalazi ili

⁷ Ako budžet obuhvata troškove zarada koja će biti debitovana za projekat, revizor će uvek pregledati troškove utvrđenih zarada ovdje.

⁸ Progresivan porez na dohodak/ porez održan na izvoru.

mane tokom revizije koje će rezultirati u pismu rukovodstva, objašnjenje ove procene treba da se navede u izveštavanju revizije.

Preduzete mere od Agencije za ravnopravnost polova za rešavanje identifikovanih slabosti u prethodnim revizijama takođe će se biti predstavljena u pismu rukovodstva.

Odabir revizora će se usvajati od SIDA

Dodatne dužnosti u skladu sa dogovorenim postupcima prema stavu III izveštavaće se u posebnom delu u skladu sa projektnim zadatkom.

Revizor treba dostaviti:

Svoj profil kojim se dokazuju stručne veštine i prethodno iskustvo i dokaz sprovođenja najmanje dveju revizija, koje je sprovodio:

- Jedno pismo, gde izražava interesovanje da realizuje takav projekat;
- Jedan kratak nacrt projekta, koji treba da obuhvata:

- 1) Detaljan plan i kalendar aktivnosti projekta;
- 2) Metodologiju rada;
- 3) Potrebnu dokumentaciju kao dokaz za druge finansijske i materijalne izvore.

Produzava se konkurs jos 7 (sedam) kalendarski dana od 18.12.2018 do 24.12.2018, od dana objavljivanja na internet stranici ARP-a : <http://abgj.rks-gov.net/>.

Podnošenje prijava se radi u Diviziji za upravu, budžet i finansije u adresi: Zgrada Vlade, 7. Sprat, Br. kancelarije 711 – Priština, svakog radnog dana od 8:00 – 16:00.

Za detaljne informacije možete kontaktirati ovaj br. tel: 038/200 14 274.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Anjisha Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shhm "Luciano Motroni " Prizren
- ▶ Erzen Xhabali shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Emin Duraku " Prizren
- ▶ Meriton Morina shpall te pavlefshme dëftesat e vitit X , XI , XII hm " 12 Maji " Ratkoc
- ▶ Bardhosh Ademaj shpall te pavlefshme diplomën shhm " Lorenc Antoni " Prizren
- ▶ Merita Hoti shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shhm "Luciano Motroni" Prizren
- ▶ Besim Morina shpall te pavlefshme diplomën e fakultetit Bachelor AAB Prishtine
- ▶ Bedri shehu shpall te pavlefshme diplomën e fakultetit Bachelor AAB Prishtine
- ▶ Ylli Shehu shpall te pavlefshme diplomën e fakultetit Bachelor AAB Prishtine
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155\
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e
Teknologjisë
 Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
 Ministry of Education, Science and Technology

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe
Teknologjisë (MASHT)
 shpall

FTESË PËR SHPREHJE INTERESI

Për recensentë për vlerësimin e dorëshkrimeve për klasat 0, 1, 6 dhe 10 të pranuar në MASHT në bazë të konkursit të datës 31 gusht 2018

Kriteret për recensentë:

1. Recensentët duhet të kenë kompetencë profesionale për vlerësimin e aspekteve të caktuara të tekstit shkollor.
 - 1.1. Kandidatët e interesuar ofrojnë një letër përcjellëse për të dëshmuar përvojën paraprake dhe kompetencën profesionale për vlerësim të dorëshkrimeve dhe aspekteve të caktuara të teksteve shkollorë dhe materialeve mësimore.
2. Recensentët kërkohet të jenë nga profilet si në vijim:
 - 2.1. Mësimdhënës universitar/punonjës shkencor i lëndës përkatëse me gradën më të lartë shkencore,
 - 2.2. Mësimdhënës i licencuar,
 - 2.3. Pedagog,
 - 2.4. Psikolog,
 - 2.5. Gjuhëtar,
 - 2.6. Ekspert nga fusha artistike,
 - 2.7. Ekspert për vlerësim të aspekteve teknike të dorëshkrimit.
3. Përzgjedhja e recensentëve dhe përcaktimi i ekipeve për fusha/lëndë të ndryshme do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara me UA Nr. 18/2018.
4. Angazhimi dhe kompensimi i recensentëve të përzgjedhur bëhet në marrëveshje me MASHT dhe në bazë të legjislacionit në fuqi.
5. Ftesa për shprehje interesi është e hapur 7 ditë që nga data kur publikohet në gazetën ditore.
6. Afati për dorëzim të aplikacioneve (CV e azhurnuar dhe letra përcjellëse për pikën 1.1) fillon me datën e publikimit në gazetën ditore dhe përfundon me 24 dhjetor 2018.
7. Aplikacionet dorëzohen në kopje fizike në zarf në zyrën numër 9, në MASHT.
8. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ftesë dhe kriteret e përcaktuara me UA nr. 18/2018 do të ftohen për angazhim.

Dhjetor 2018, PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e
Teknologjisë
 Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
 Ministry of Education, Science and Technology

Ministarstvo obrazovanja, nauke i
tehnologije (MONT), objavljuje

POZIV ZA IZRAŽAVANJE INTERESA

za recenzente za ocenjivanje rukopisa za razrede 0, 1, 6 i 10 primljenih u MONT na osnovu konkursa od 31. avgusta 2018.

Kriterijumi za recenzente:

1. Recenzenti treba da imaju stručnu nadležnost za procjenu određene aspekte školskih udžbenika.
 - 1.1. Kandidat dostavlja propratno pismo da dokaže prethodnog iskustva i profesionalne kompetentnosti za ocenjivanje rukopisa i određenih aspekata školskih udžbenika i nastavnog materijala.
2. Zahtjeva se da Recenzenti budu iz sljedećih profila:
 - 2.1. Predavači sa univerziteta / naučni radnici odgovarajućeg sa najvišim naučnom gradom,
 - 2.2. Licencirani nastavnici,
 - 2.3. Pedagog,
 - 2.4. Psiholog,
 - 2.5. Predavač jezika,
 - 2.6. Ekspert u oblast umetnosti
 - 2.7. Ekspert za procjenu tehničkog aspekta rukopisa.
3. Izbor recenzenata i određivanje ekipe za različite oblasti/predmete vrši će se prema procedurama utvrđenim AU Br. 18/2018.
4. Angažovanost i nadoknada recenzentima koji budu izabrani se vrši uz dogovor sa MONT-om i u skladu sa važećim zakonodavstvom.
5. Poziv za izražavanje interesa je otvoren 7 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama.
6. Rok za podnošenje prijave (ažuriran CV i prateće pismo za tačku 1.1) počinje na dan objavljivanja u dnevnom novinama i završava 24. decembra 2018. godine.
7. Prijave se dostavljaju u fizičku kopiju u koverti kancelarija broj 9 u MONT-u.
8. Samo kandidati koji ispunjavaju uslove predviđene ovim pozivom i kriterijima utvrđenim u AU br. 18/2018 će biti pozvani na angazman.

Decembar 2018, PRIŠTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e
Teknologjisë
 Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
 Ministry of Education, Science and Technology

Eğitim Bilim Ve Teknoloji Bakanlığı

31 Ağustos 2018 tarihli duyuruya göre 0, 1, 6 ve 10. sınıflar için El yazmaları ve öğretim materyallerinin değerlendirilmesi için

Duyuru

Yayınlıyor

Değerlendirme Uzmanı için Kriterler:

1. Değerlendirme uzmanı, ders kitabın el yazıları ve öğretim materyallerinin belirli yönlerini değerlendirmek için mesleki yeterliliğe sahip olmalıdır.
 - 1.1. Değerlendirme uzmanı, ders kitabın el yazıları ve öğretim materyallerinin yönlerini değerlendirmek için önceki deneyimi ve mesleki yeterliliği kanıtlamak için referans hazırlar.
2. Değerlendirme uzmanı aşağıdaki branşlardan olmalıdır:
 - 2.1. Üniversite öğretim üyesi . (En yüksek ünvana sahip olan bilim adamı)
 - 2.2. Lisanslı Öğretmen,
 - 2.3. Pedagog,
 - 2.4. , Psikolog
 - 2.5. , Dilbilimci
 - 2.6. Sanat alanında uzman
 - 2.7. El yazının teknik yönlerini değerlendiren uzman.
3. EBTB 18/2018 tarihli numarasına dayanarak Değerlendirme uzmanı ataması yapılır.
4. EBTB ile yapılan anlaşmaya ve yürürlükteki yasalara göre Seçilen Değerlendirme uzmanları angaje eder ve tazminat verir.
5. Duyuru, günlük gazetelerde yayınlandığı tarihten itibaren 7 gün açıktır.
6. Başvuruların sunulması (CV ve 1.1 numaralı mektup için destekleyici mektup), günlük gazetelerde yayınlanma tarihinde başlar ve 24 Aralık 2018'de sona erer.
7. Başvurular EBTB'te 9' numaralı ofiste kapalı zarf içinde teslim edilir.
8. IT 18/2018 sayılı numarasına dayanarak şartları uygun olan adaylar davet edilecek.

Aralık 2018, PRIŠTINA

FITO 2 SUPER muaj FALAS me SuperDUO!

Abonohu në ndonjë të ndonjë nga pakot **SuperDUO** dhe paguaj vetëm 10 muaj, ndërsa 2 të fundit merri **FALAS**. Përveç kësaj, fiton edhe **3 SIM kartela me 3 muaj komunikim FALAS** brenda rrjetit të IPKO-së. Pagesa mund të bëhet në baza mujore.

Pakot e **SuperDUO** janë pakot më të kompletuara në treg. Ato ofrojnë internet mbi **50Mbps** dhe përmbajtje mbi **150 kanale televizive** me të gjitha ligat më emocionuese të futbollit (Premier League, Serie A, La Liga), si dhe kanalet sportive më të popullarizuara botërore.

ÇKA O' SUPER O' SUPER!

Merr ofertën në dyqanin më të afërt të IPKO-së.

*Nxito, oferta është promovionale.

WWW.IPKO.COM

